



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË-2020

Korrik 2021

## PËRMBAJTJA

1. PARATHËNIE.....	6
2. PERFORMANCA E KRU-ve.....	8
2.1 FURNIZIMI MË SHËRBIME TË UJIT .....	8
2.1.1 Performanca jo-financiare (teknike).....	8
2.1.2 Performanca jo-financiare (komerciale).....	12
2.1.3 Performanca financiare.....	15
2.2 SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA .....	21
2.2.1 Performanca jo-financiare (teknike).....	21
2.2.2 Performanca jo-financiare (komerciale).....	22
2.2.3 Performanca financiare.....	23
2.3 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E KRU-ve.....	28
2.3.1 Arkëtimi i të ardhurave.....	28
2.3.2 Kthimi në kapital .....	29
2.3.3 Struktura e shpenzimeve operative.....	30
2.4 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E KRU-ve.....	31
2.4.1 Performanca e përgjithshme - shërbimi i furnizimit me ujë .....	33
2.4.2 Performanca e përgjithshme –shërbimi me ujëra të ndotura .....	35
2.4.3 Performanca e përgjithshme e KRU-ve.....	37
3. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT MË SHUMICË.....	39
4. KUALITETI I TË DHËNAVE .....	40
5. KONKLUSIONE TË PËRGJITHSHME.....	42
SHTOJCA 1: Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave (URRK) .....	44
SHTOJCA 2: Detajet e kontaktit .....	47
Informacionet për ARRU .....	47

## MISIONI

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”

## VIZIONI

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

## Akronimet

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BPRR	Biznes Planet Rregullatore
BRRA	Baza Rregullatore e Aseteve
BD	Bordet e Drejtorëve
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IÇKK	Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë
KNMU	Këshilli Ndërmintrosor për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujësllësit
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
QU	Qendra e Ujit
UPF	Uji i Pa-Faturuar
ITUN	Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura
UA	Udhëzimi Administrativ
UKRR	Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator
O.SH	Ofruesit e Shërbimeve
SIG	Sistemi Informativ Gjeografik
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
GNI	Grupi Ndërinstitucional (Qeveria, ARRU, KRU, SHUKOS).

## 1. PARATHËNIE

Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë-2020, vlerëson performancën e shtatë ofruesve të shërbimeve (KRU) dhe një ndërmarrje të furnizimit të ujit me shumicë të patrajtuar (N.P.H Ibër-Lepenci). Botohet nga ARRU në baza vjetore me qëllim të vlerësimit dhe krahasimit të trendëve të performancës së punës me kalimin e kohës në një numër fushash, përmes treguesve të punës, përfshirë edhe treguesit kyç të performancës. Programi i monitorimit i zbatuar nga ARRU, është gjithëpërfshirës dhe thelbësor për mbikëqyrjen e ofruesve të rregulluar si dhe nxitje të konkurrencës përmes krahasimit dhe benchmarkingut. Pas përfundimit të çdo viti financiar, kompanitë raportojnë të dhënat e tyre me përgjegjësinë për saktësi dhe besueshmëri, përderisa auditohen nga ARRU, për të vlerësuar saktësinë dhe gjithashtu besueshmërinë e tyre. Përfundimisht këto të dhëna janë bazë e përpilimit të raportit vjetor, ku pasqyrohet performanca e sektorit të shërbimit me ujë dhe trajtim të ujërave të ndotura.

Fokusi kryesor si rregullator është të promovojnë interesat afatgjata në sektorin e shërbimeve të ujit duke siguruar fonde të mjaftueshme për KRU, për të mbuluar kostot e tyre themelore të operimit dhe mirëmbajtjes (O&M), si dhe mjete të arsyeshme për investime kapitale në mënyrë që ti mbajnë nivelet e shërbimit për konsumatorët ekzistues, duke lënë vend që fondet e qeverisë, komunave dhe donatorëve të paguajnë për zgjerimin e qasjes në shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullim dhe trajtim të ujërave të ndotura.

Viti 2019–2020, ka qenë tepër sfidues, me një gjendje të pashembullt, meqenëse ishim dëshmitarë të pandemisë (COVID-19) me përmasa globale i cili vazhdon të ketë ndikim në mirëqenien dhe ekonominë e vendit. Ne vazhduam të punojmë me ofruesit e shërbimeve të ujit në mënyrë që konsumatorët e ujit të kenë shërbime cilësore, veçanërisht gjatë këtyre ditëve të vështira, duke kontribuar në menaxhimin dhe kufizimin e përhapjes së pandemisë për të siguruar disponueshmëri të vazhdueshme me ujë të pastër dhe të sigurt për konsum dhe higjienë në përgjithësi. Ne dhe palët e tjera të interesit besojmë që do të punojmë me KRU-të, për të kuptuar efektet e plota të pandemisë Covid-19, në fushat të caktuara, megjithëse evidente tani më janë pasojat në efikasitetin e arkëtimit e padyshim se ndikim negativ ka edhe tek realizimi i projeksioneve në investime kapitale.

Në përgjithësi, performanca e KRU-ve në vitin 2020 ka shënuar rënie në raport me vitin 2019, përmirësimet ka pasur në disa tregues, përderisa tek disa të tjerë, si efikasiteti operativ (vazhdimësia e furnizimit me ujë) dhe ajo financiare janë evidentuar ngecje.

Edhe përkundër kësaj, sektori regjistroi disa hapa pozitivë, në disa prej treguesve kyç të punës. Përderisa për gjatë disa viteve të fundit, ofruesit e shërbimeve ishin të angazhuar për të rritur kapacitetet e prodhimit në mënyrë që konsumatorët të kenë furnizim të rregullt. Ata njëkohësisht janë angazhuar po ashtu edhe për të zgjeruar qasjen në shërbimin me ujë, ku 3% e popullatës në vitin 2020 ishin kyçur në sistemin publik megjithëse ende rreth 20% e popullatës, kryesisht të zonave të thella rurale presin që të kenë shërbime me ujë në vendbanimet e tyre. Evidente është se progresi, nuk ka ecur me të njëjtin tempo në shtrirjen e sistemit të kanalizimit, ku vetëm rreth 65% e popullatës janë të kyçur në sistemin e kanalizimit. Rritja e qasjes në furnizim të sigurt me shërbime të ujit, do të kërkojë edhe më tej shumë investime në infrastrukturë, sidomos viteve të ardhshme kjo do të jetë sfidë për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura.

Vlen të theksohet se për shkak të thatësisë e cila vazhdoi edhe në vitin 2020, disa nga ofruesit e shërbimeve si: KRU “Hidromorava”, dhe KRU “Bifurkacioni”, por në një masë më të vogël edhe KRU “Prishtina”, nuk kanë arritur të përmbushin obligimin për furnizim të rregullt me ujë për pije, ishin pra të detyruar të aplikojnë ndërprerje të planifikuara të furnizimit dhe menaxhim të kujdesshëm me resurse ujore. Autoriteti i sugjeron, këto kompani të kërkojnë dhe zhvillojnë burime të qëndrueshme për të siguruar furnizim të vazhdueshëm me ujë për pije për konsumatorët e tyre për një periudhë afatgjate.

Cilësia e ujit, po ashtu ishte ndikuar për shkakun e reduktimeve të ujit tek tri kompanitë e lartë cekura, ndonese të gjitha KRU, në përgjithësi kanë siguruar pajtueshmëri shumë të lartë të cilësisë së ujit.

Është inkurajuese fakti se tani më tri KRU si “Prishtina”, “Gjakova” dhe “Hidroregjioni Jugor” i kanë të akredituara laboratorët e testimit të cilësisë së ujit sipas kritereve të caktuara nga institucioni përgjegjës i

qeverisë. Kompanitë e tjera janë duke i ndërtuar hapësirat e laboratorëve dhe pajisjet e tyre me aparatura dhe staf në mënyrë që të ju nënshtrohen procesit të akreditimit. Ky do të jetë një hap i rëndësishëm në sigurimin e besueshmërisë në të gjithë zinxhirin e monitorimit të cilësisë së ujit.

Me gjithë trendët pozitive në disa nga KRU, uji i pa-faturuar vazhdon të ketë nivele të larta pa përjashtim. Ky ujë humbet si pasojë e rrjedhjeve dhe shpërthimeve që rrjedhin nga një presion i lartë në rrjetë meqenëse në një normë të lartë ka ndikuar infrastruktura e vjetërsuar, dëmtimet nga punimet e konsiderueshme në infrastrukturën rrugore, lidhjet e paligjshme, performanca e dobët e ujëmatësve dhe leximit të pasaktë të tyre, etj., me gjithë këtë duhet vazhduar përpara. ARRU do të vazhdojë të punojë me Ministrinë përgjegjëse, NJPM-NP, KNMU dhe palët e tjera kryesore për tu përqendruar në sigurimin e marrjes së masave praktike në mënyrë që të adresohet niveli i lartë i UPF. ARRU është e përkushtuar të sigurojë që sektori të vazhdojë të përmirësohet si dhe ti mbështes KRU-të duke përkrah planet e tyre strategjike për reduktimin e UPF (2018-2022) si dhe objektivat e projektuara në planet e tyre të biznesit për procesin e ardhshëm tarifor (2021-2023).

Efiçenca e arkëtimit, në të gjitha KRU-të është përqësuar, kjo është hera e parë që norma e arkëtimit ka shënuar rënie që kur ka filluar me programin e monitorimit nga ARRU. Kjo kryesisht për shkakun e ngadalësimit të aktivitetit gjatë pandemisë COVID-19. Efiçenciteti mesatar i arkëtimit të të hyrave në nivel sektori është 84% dhe kjo është më e ulët për 9% në krahasim me vitin 2019.

Padyshim se ndikimi është edhe tek realizimi i projeksioneve në investime kapitale. Kompanitë kishin planifikuar vlera të konsiderueshme të investimeve kapitale nga mjetet vetanake por edhe nga donacionet, për tu investuar në mirëmbajtje dhe rritje kapitale si në shërbimin me ujë e po ashtu edhe në shërbimin me ujëra të ndotura për vitin 2020 por vetëm një pjesë e tyre e vogël janë realizuar.

Si do që të jetë, ne edhe në këtë raport kemi përfshirë informacione të rëndësishme për palët tona të interesit që besojmë se janë prezantuar në mënyrë të drejtë, të ekuilibruar dhe të kuptueshme.

Ne i kemi dëgjuar palët tona të interesit përmes kanaleve të shumta të komunikimit dhe kemi reflektuar në angazhimin tonë për të zhvilluar një qasje transparente në raportimin e asaj që ka rëndësi duke plotësuar kështu edhe kërkesën ligjore në lidhje me monitorimin dhe raportimin e performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit.

Përfundimisht edhe një herë po e potencojmë se ky vit, ka qenë një vit sfidues për institucionin tonë, sektorin e ujit dhe në përgjithësi popullatën për shkak të pandemisë COVID-19, ku menaxhimi i saj krahas angazhimit për zbatimin e përgjegjësive ishte i vështirë.

Duke shpresuar se kjo gjendje të tejkalohet dhe pasojat të sanohen sa më shpejtë, falënderoj dhe shprehi mirënjohjen time për të gjithë stafin e ARRU dhe zyrtarët e KRU-ve, për angazhimin e tyre në përpilimin e këtij raporti.

Me respekt,

Xhelal Selmani, Zëvendës Drejtor i ARRU-së


## 2. PERFORMANCA E KRU-ve

### 2.1 FURNIZIMI MË SHËRBIME TË UJIT

#### 2.1.1 Performanca jo-financiare (teknike)

##### Cilësia e ujit

Ky tregues paraqet përqindjen e mostrave të analizuara që janë në pajtueshmëri me vlerat parametrike për cilësinë e ujit për pije, në aspektin fiziko-kimik po ashtu edhe në aspektin bakteriologjik. Pajtueshmëria vlerësohet në kuadër të udhëzimit administrativ-16/2012 për ujë të pijshëm. Standardet e kualitetit të ujit të pijshëm në vendin tonë janë në përputhje me vlerat e standardeve të referuara nga Direktiva e Ujit të Pijshëm 98/83/EC.



**Fig.1.** Kualiteti i ujit për vitet 2019 dhe 2020 H1

Gjatë vitit 2020 H1, janë testuar gjithsejtë 4,408 mostra prej të cilave 99.4%, janë në përputhje me standardet e cilësisë së ujit për pije. Sa i përket aspektit bakteriologjik janë testuar gjithsejtë 3,020 mostra ku prej tyre 99.5% e tyre kanë qenë në përputhje me vlerat parametrike të lejuara ndërsa në aspektin e cilësisë fiziko-kimike janë testuar 1,388 mostra nga të cilat 99.4% rezultuan të jenë në përputhje me vlerat e lejuara.

KRU-të kanë siguruar pajtueshmëri shumë të lartë të cilësisë së ujit megjithëse vendi u ballafaqua me thatësi gjatë vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020. KRU “Hidromorava”, “Bifurkacioni” dhe KRU “Prishtina” ishin të detyruara që të bëjnë reduktime të ujit, me ç’rast cilësia e ujit ishte ndikuar me së shumti.

Të dhënat e pajtueshmërisë bakteriologjike dhe fiziko-kimike për periudhën 2020H1 dhe vitin 2019, janë paraqitur në Fig.1 dhe Tab.1.


**Tab. 1.** Norma(%) e testeve mikrobiologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit për KRU-2020 H1.

KRU	PR	PZ	PE	MIT	GJA	FE	GJI	SEK
Mikrobio.	99.9%	99.0%	99.2%	100%	100.0%	97.5%	99.3%	<b>99.5%</b>
Fiz.-Kim.	100%	98.1%	100.0%	97.9%	100.0%	96.3%	100%	<b>99.4%</b>
Mesatarja	<b>99.9%</b>	<b>98.8%</b>	<b>99.4%</b>	<b>99.5%</b>	<b>100.0%</b>	<b>97.1%</b>	<b>99.5%</b>	<b>99.4%</b>

Është inkurajues fakti se tani më tri KRU “Prishtina”, “Gjakova”, dhe KRU “Hidroregjioni Jugor” i kanë akredituar laboratorët e testimit të ujit. Kompanitë e tjera janë duke i ndërtuar hapësirat e laboratorëve dhe pajisjet e tyre me aparatura dhe staf në mënyrë që të ju nënshtrohen procesit të akreditimit.

### Presioni i ujit

Ky tregues, pasqyron përqindjen mesatare të pronave të lidhura që kanë furnizim me ujë të pijshëm, e që në rrethana normale, nuk mund të ju garantohet presion i ujit (1.5-7bar) në rubinetet e tyre.




**Fig.2.**Përqindja e pronave të cilat kanë probleme me presion të ulët

Sikurse gjatë vitit 2019 edhe në vitin 2020, vetëm KRU “Hidromorava”, ka raportuar prona që kanë probleme me sigurimin e presionit nën nivelin referent dhe atë në vlerë prej 6,000 prona. Kryesisht e lidhur me mungesën e furnizimit të rregullt. Shumica e KRU-ve ende nuk kanë mundësinë që të monitorojnë dhe sigurojnë informacione të besueshme për presionin në rrjetin e tyre të shërbimit, ato nuk kanë sistem të vendosur të manometrave dhe monitorimit On-line të rrjetit shpërndarës. ARRU i ka vlerësuar me besueshmëri të dobët të dhënat në lidhje me presionin e ujit.

### Vazhdimësia e furnizimit me ujë

Besueshmëria e shërbimit përfaqëson njërin nga standardet e rëndësishme të shërbimit, e cila paraqet përqindjen e pronave të shërbyera në vazhdimësi me ujë të ndarë në tri kategori: prona që kanë furnizim 24 orë, 18-23 orë dhe prona që kanë më pak se 18 orë furnizim, duke përjashtuar, rastet e veçanta që mund të ndodhin siç janë: ndërprerjet për shkak të problemeve teknike që ndodhin në teren apo ndërprerje për punë të planifikuara të Kompanisë.





**Fig.3.** Norma (%) e konsumatorëve me furnizim të rregullt me ujë të pijshëm

KRU-të të cilat furnizojnë konsumatorët e tyre 24 orë me ujë të pijshëm janë: KRU “Gjakova”, “Mitrovica” dhe KRU “Hidroregjioni Jugor”, por edhe kompanitë tjera nuk qëndrojnë keq sa i përket këtij treguesi duke kaluar vlerën mbi 90% të furnizimit 24 orë me ujë të pijshëm për konsumatorët e tyre me përjashtim të KRU “Hidromorava” e cila vetëm 6.4% të konsumatorëve të saj i furnizon 24 ore me ujë të pijshëm, kryesisht për shkakun e mungesës së resurseve ujore në Liqenin e Perlepticës.


Nga analizat tona vijmë në konkludim se për të gjitha KRU-të në nivel vendi, kërkesa për ujë është më e ulët se disponueshmëria me ujë e burimeve të ujit, por kjo nuk është e shpërndarë gjeografikisht. Kjo vlenë sidomos për zonën e mbulueshmerisë nga KRU “Bifurkacion” dhe KRU “Hidromorava”, të cilat kanë një shfrytëzim të madh të resurseve ujore në dispozicion, kjo duhet adresuar nga KRU respektive. Autoriteti sugjeron investime në sisteme për optimizimin e shfrytëzimit të burimeve ujore që garantojnë një furnizim të besueshëm dhe që u përshtatet kërkesave në të ardhmen nga këto dy kompani.

Viteve të fundit, ndërprerja e furnizimit me ujë për shkak të punimeve është bërë e zakonshme për shkakun e punimeve të shumta në infrastrukturën rrugore, dhe kjo ka ndikuar që KRU-të vazhdojnë të kenë probleme me rrjedhje të gypave të ujit dhe qëndrueshmërinë e furnizimit.

### Plasjet e gypave

Numri i plasjeve për 100 km gjatësi të rrjetit të ujësjellësit, paraqet numrin e përgjithshëm të shpërthimeve dhe rrjedhjeve në të gjithë rrjetin e sistemit të shpërndarjes (duke përjashtuar gypat e shërbimit të kyçjes). Është një tregues që vlerëson gjendjen e rrjetit të ujësjellësit.

Të dhënat mbi numrin e shpërthimeve dhe rrjedhjeve kryesore të ujit për 100 km gjatësi të rrjetit të ujësjellësit për të gjitha ndërmarrjet dhe në nivel të përgjithshëm të raportuara në 2020/2019, janë paraqitur në fig.4.




**Fig. 4.** Numri i defekteve në rrjetin e ujësjellësit për 100 km

Trendi mesatar i defekteve në nivel të përgjithshëm është në rënie. Gjatë vitit 2020 numri i defekteve në rrjetin e ujësjellësit për 100 km gyp variojnë nga 317 raste në KRU “Gjakova”, deri në rastin më të mirë tek KRU “Hidromorava” me 85 raste në 100 km rrjet. Rritje të numrit të defekteve gjatë vitit 2020/2019 për 100 km gyp kanë raportuar KRU “Prishtina” me 17 raste dhe KRU “Hidrodrini” me 73 raste me shumë .

Numri i defekteve në rrjetin e tubacioneve po ndikohet nga faktorë të ndryshëm duke përfshirë: vjetërsinë dhe material të dobët të tubave, mungesa e mirëmbajtjes adekuatë nga ana e KRU si dhe punimet në rrugë nga ana e operatorëve të ndryshëm të cilët jo rrallë herë kanë qenë të pa kujdesshëm ndaj infrastrukturës së ujësjellësit.

### Uji i pa faturuar

Një nga sfidat kryesore me të cilat përballen, ofruesit e shërbimeve të ujit në vend është mospërputhja e madhe në mes të sasisë së ujit të prodhuar dhe të vendosur në sistemin e shpërndarjes si dhe sasisë së ujit të faturuar për konsumatorët. Uji i humbur në aspektin komerciale dhe atë fizik, ndikon drejtpërdrejt në mbulimin e kostos dhe profitin, është një nga treguesit e synuar për të adresuar efikasitetin operacional dhe financiar. Në këtë seksion diskutimi i UPF është bazuar në llogaritjen e tij si përqindjen dhe si vlerë sasiore në raport me totalin e vëllimit të prodhuar dhe distribuuar në rrjetin shpërndarës.



**Fig. 5.** Norma e UPF (%)


Sasia e UPF gjatë vitit 2020 nga të gjitha kompanitë kap vlerën mbi 84 mil.m<sup>3</sup> apo krahasuar me vitin 2019, mbi 3.2 mil.m<sup>3</sup> më pak sasi të ujit të pa-faturuar.

Në nivel sektori norma e UPF gjatë vitit 2020 ka rënë në 55%, kjo është për 1% më pak se në vitin 2019.

Disa prej kompanive kanë shënuar progres në zvogëlimin e UPF përgjatë këtij viti vlerësues siç janë KRU “Gjakova”, “Hidromorava”, “Mitrovica” dhe KRU “Hidroregjioni Jugor”. Edhe përkundër progresit që kanë shënuar disa prej kompanive gjatë këtij viti të analizës të gjitha KRU pa përjashtim janë larg nivelit të pranueshëm prej 25%.

KRU “Bifurkacioni”, ka nivelin më të lartë të UPF prej 64%, duke u pasuar pastaj nga KRU “Hidrodrini” dhe KRU “Prishtina”. Sa i përket zvogëlimit të UPF, në pozitë më të mirë qëndron KRU ‘Gjakova’, ku niveli i humbjeve të ujit ka shënuar trend të rënies vit pas viti dhe aktualisht norma është 42%.

Në figurën e më poshtme janë dhënë statistikat e normave të performancës së realizuar dhe normave projektuese për zvogëlimin e UPF të cilat ishin të aprovuara nga ARRU për vitin 2020.



**Fig.6. Norma (%) e ujit të pa-faturuar (planifikimi-realizimi) - 2020**

Asnjë nga KRU-të, nuk kanë arritur ti përmbushin objektivat e planifikuara me procesin tarifar. Në rastin më të mirë KRU “Gjakova” ishte afër arritjes së objektives për vitin 2020, ku realizimi ishte me i ulët se planifikimi për 2%.


Humbjet ujit kanë ndodhur për shkak të rrjedhjeve në rrjetin shpërndarës para njehsorit të konsumatorit dhe rrjedhjet në rezervuarët e ujit të pijshëm, gabimet/vlerësimet në matje, konsumin e pa-autorizuar kycjet ilegale dhe konsumin e autorizuar të pa-faturuar (për shembull, uji i përdorur për shuarjen e zjarrit, objektet e kultit, krojet publike, etj).

ARRU gjithnjë ka sugjeruar se për të pasur sukses duhet krijuar struktura të qëndrueshme, brenda kompanisë me, staf profesional, mjete dhe teknologji të avancuar, trajnime të nevojshme si dhe stimuj financiar për përmbushjen e objektivave, duke marrë parasysh se ballafaqimi me humbjet e ujit do të jetë një punë e vazhdueshme për ofruesit e shërbimeve të ujit. Po ashtu sugjerojmë kompanitë në adresimin e ujëmatjes se: **“pa matje totale që përfshin pikat e prodhimit dhe konsumit, përpjekjet për të zvogëluar UPF, janë të kota”.**

### 2.1.2 Performanca jo-financiare (komerciale)

#### Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës që furnizohen nga sistemet e menaxhuara nga KRU-të në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së licencuar të shërbimit.



**Fig. 7. Norma (%) e mbulueshmerisë së popullatës me shërbime të ujësjellësit**

KRU-të si ofrues të licencuar të shërbimeve të ujësjellësit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura sigurojnë shërbime të ujësjellësit tek 78% e popullatës<sup>1</sup>.

Në pozitën më të mirë sa i përket treguesit për mbulueshmërinë me shërbime të ujësjellësit gjatë vitit 2020 qëndron KRU "Gjakova" me 99% mbulueshmëri e cila nëse krahasohet me vitin paraprak 2019 ka shënuar progres për 9% dhe tek e cila vlerë ka ndikuar futja nën menaxhim e rreth 30 vend-banimeve të regjionit (rekë e keqe) me mbi 12 mijë banorë.

Në përgjithësi të gjitha KRU-të kanë shënuar progres gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin paraprak 2019 edhe pse ende qëndrojnë larg nivelit ideal të mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit prej 100%.


KRU "Hidromorava" ka shtrirjen më të ulët të shërbimeve me vetëm 61% edhe pse e cila në krahasim me vitin paraprak 2019 ka rritje prej 2%. Pra edhe rreth 1/3 e popullatës nga zona e shërbimit të kësaj kompanie presin për tu kyçur në sistemin publik të furnizimit me shërbime të ujit.

Diku rreth 106 sisteme në zona rurale kanë mbetur ende pa u futur nën menaxhimin e KRU-ve respektive. Këto sisteme posedojnë infrastrukturën e nevojshme deri tek gypi i lidhjes së konsumatorit, disa prej tyre rishtazi janë rehabilituar dhe ekzistojnë lidhjet individuale, por për shkakun e rezistencës nga popullata ende nuk janë nën menaxhim të KRU-ve. Në këto raste do të duhej të shikohej mundësia për vetëdijësimin e këtyre banorëve për pasojat e konsumit të ujit të pakontrolluar nga ana e institucioneve përgjegjëse. Përveç përparësive ambientale dhe shëndetësore, marrja nën menaxhim e këtyre sistemeve duhet të shihet edhe në interes të vetë KRU-ve meqenëse kjo do të duhej të ndikonte edhe në rritjen e efikasitetit të KRU-ve përmes ekonomisë së shkallës, gjegjësisht zvogëlimit të kostos mesatare për njësi që rezulton nga rritja e madhësisë së operimit – zonës së shërbimit.

### Matja e ujit

Matja e ujit të konsumuar është një prej standardeve të rëndësishme të shërbimit të ujit, është parakusht për një faturim të drejtë duke i ngarkuar konsumatorët në bazë të konsumit të tyre real. Matja e ujit gjithashtu është edhe një mjet i rëndësishëm për kontrollin e konsumit dhe humbjeve të ujit.

<sup>1</sup>Të dhënat për popullatën janë marrë nga raportet përkatëse të publikuara nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës (më saktë nga Raporti i Censurit 2011 dhe Raporti i Parashikimit të Popullatës 2017-2061)




**Fig.8.** Norma(%) konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Të gjitha KRU-të kanë shënuar performancë të mirë tek pajisja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës, gjatë vitit 2020 në raport me vitin paraprak 2019, progresi është për 2% gjatë vitit 2020 në raport me vitin paraprak 2019. KRU “Mitrovica” ende qëndron në nivel të ulët në këtë standard shërbimi, ku vetëm 85%, e konsumatorëve të saj shtëpiak kanë të vendosur ujëmatës. Përderisa të gjitha kompanitë e tjera kanë një përqindje të lartë të mbulueshmërisë me ujëmatës, megjithëse standardi ligjor i nivelit të shërbimit për matjen e ujit kërkon nga KRU-të që faturimin e të gjithë konsumatorëve të tyre ta bëjnë vetëm përmes ujëmatësve funksional dhe të verifikuar në aspektin e saktësisë.

Në vazhdimësi ARRU ka kërkuar nga të gjitha ndërmarrjet e ujit të vendosin matjen e detyrueshme të konsumit të ujit nga konsumatorët. Katër nga KRU (Bifurkacioni, Hidroregjioni Jugor, Hidrodrini dhe Gjakova) i kanë përmbushur detyrimet e dhëna për faturimin e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës 100%. Sidoqoftë, KRU-të kanë raportuar mbi 21,772 ujëmatës të rinj të instaluar vetëm për kategorinë e amvisërisë në vitin 2020. ARRU vazhdon t'i monitorojë kompanitë nga afër dhe presim që ato të eliminojnë plotësisht faturimin pa ujëmatës përgjatë vitit 2021.

### Ankesat

Numri i ankesave është një tregues i rëndësishëm për vlerësimin e kënaqshmërisë së konsumatorëve në lidhje me shërbimin e marrë nga ofruesi i tyre i shërbimeve.



**Fig. 9.** Numri i ankesave për shërbimin e ujësjellësit

Gjatë vitit 2020 numri i ankesave teknike por edhe atyre të natyrës komerciale, drejtuar KRU nga ana e konsumatorëve për shërbimin e ujës jellësit ka shënuar rritje për 7,211 ankesa apo shprehur në përqindje 69% në raport me vitin paraprak 2019.

Janë gjithsej 17,655, ku prej tyre 15,108 janë ankesa të natyrës teknike të lidhura kryesisht me: presionin, ndërprerjet si dhe prishjet/rrjedhjet, ndërsa 2,547 janë ankesa komerciale që kanë të bëjnë kryesisht me kontestimet e borxheve, kërkesa për shlyerje të borxheve, faturim pa matje, mos lexim të rregullt të ujmëtarëve. Më tepër ankesa janë të adresuara nga konsumatorët e amvisërisë, por ka ankesa edhe nga kategoria e bizneseve, ndërsa një numër më i vogël i nga konsumatorët institucional.


ARRU, ka ende ka rezerva sa i përket besueshmërisë së këtyre të dhënave, shumica e KRU kanë në përdorim programe të avancuara softverike (CRM, CRS), por mungon përditësimi-azhurnimi i rregullt dhe saktë i definuar, pra KRU-të duhet të mbajnë një regjistër të përditësuar dhe unik të ankesave të konsumatorëve.

Ankesat e konsumatorëve, tregojnë pakënaqësitë ndaj shërbimeve të ofruara nga kompanitë e ujit, ato edhe janë përgjegjës për shqyrtimin dhe trajtimin e tyre me kujdes dhe brenda një afati kohor të përcaktuar me kornizën ligjore. Nëse një kompani nuk mund të zgjidhë një ankesë direkt me konsumatorin atëherë ai mund ta referojë çështjen tek ARRU “Komisioni për zgjedhjen e Ankesave” për hetime të mëtutjeshme dhe zgjidhje të saj. Gjatë vitit 2020 në këtë komision janë adresuar 202 ankesa dhe prej tyre janë trajtuar 199-sish ku 3 ankesa janë bartur për tu shqyrtuar në vitin 2021. Kryesisht natyra e ankesave ishte e lidhur me aspektin komercial.

### 2.1.3 Performanca financiare

#### Volumi i ujit të shitur

Gjatë procesit tarifar 2018-2020, KRU-të i kanë paraqitur projeksionet e tyre për volumin e ujit të shitur në mënyrë që t'i furnizojnë konsumatorët e tyre. Për vitin 2020 janë planifikuar të faturohen mbi 66 milion m<sup>3</sup> ujë nga të gjitha KRU-të, përderisa kanë arritur të realizojnë mbi 62 milion m<sup>3</sup>, për rreth 4 milion m<sup>3</sup> më pak realizim apo shprehur në përqindje 94%, përjashtuar ujin më shumicë për pjesën veriore.




**Fig.10.** Normat sasiore për ujin e shitur nga KRU në raport me vlerësimet sipas planit të biznesit

Në nivel sektori shitjet volumetrike të realizuara në raport me ato të planifikuara kanë shënuar performancë me një rritje simbolike nga 93% sa ishin gjatë vitit 2019 në 94% në vitin 2020. Caku i planifikuar është përmbushur dhe tejkaluar nga KRU “Mitrovica” dhe KRU “Hidromorava”. Ngecjet në realizimin e planifikimit janë identifikuar tek të gjitha KRU tjera edhe pse KRU “Gjakova” dhe KRU “Hidrodrini” janë afër realizimit të planit me vlerë mbi 90%.

### Vlera e shitjeve

Vlera totale e shitjeve të ujit është një tregues i rëndësishëm i performancës financiare përmes të cilës mbuloheh shpenzimet operative dhe mirëmbajtja kapitale duke krijuar vetë qëndrueshmëri financiare.

Në figurën si me poshtë është paraqitur performanca e shitjeve të ujit në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU-ve për procesin tarifor 2018-2020 (viti 2019 dhe 2020).




**Fig.11.** Vlera e shitjeve të shërbimi i furnizimit me ujë në raport me shitjet e planifikuara

Vlera e shitjeve në shumicën e KRU-ve edhe këtë vit ishte me e ulët se sa vlera e planifikuar e shitjeve. Mos realizimi i shitjeve të ujit, para së gjithash është rezultat i parashikimeve të dobëta të volumit të shitjeve, siç edhe është paraqitur në treguesin paraprak Fig.10.

Vlera e shitjeve e realizuar për vitin 2020 në nivel të sektorit për furnizim me ujë ishte 30,3 mil.€ ndërsa ajo e planifikuar rreth 33 mil.€ që do të thotë se 91% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar, dhe është me e ulët për 1% krahasuar vitin 2019 që ishte 92%.

Sa i përket performancës së shitjeve në nivel të kompanive, edhe këtë vit prinë KRU “Mitrovica” me % më të lartë të caktuar prej 119%, duke tejkaluar cakun e planifikuar për 19%, përderisa KRU “Bifurkacioni” mbetet me % e realizimit me të ulët prej 84%, e cila përqindje ka mbet në nivel të njëjtë me vitin paraprak.

### Vlera relative e shitjeve



**Fig.12.** Vlera relative e shitjeve të shërbimi i furnizimit me ujë gjatë 2020 në raport me vitin 2019

Fig.12, tregon trendët e vlerës së shitjeve të realizuara për shërbimet e ujësjellësit gjatë periudhës raportuese 2020 në raport me vitin 2019. Këtë vit vetëm tri prej shtatë kompanive kanë treguar progres në këtë shërbim.

KRU “Mitrovica” është kompania e cila ka realizuar shitjet me të lartat në vitin aktual me 11.36% në raport me vitin paraprak, rezultat i të cilës rritje ka qenë rritja e shitjeve të ujit në vlerë sasiore, përkundër zvogëlimit të ujit të prodhuar.


Në vlerë absolute shitjet në euro në nivel sektori në 2020 janë më të ulëta për -1.67% në raport me vitin 2019 si rezultat i zvogëlimit të tarifës volumetrike për furnizim me ujë në kategorinë e konsumatorëve komercial/institucional, përkundër rritjes së lehtë të shitjeve volumetrike.

Fig.12, tregon që efikasiteti i faturimit është një fushë ku KRU-të duhet të arrijnë, progres të konsiderueshëm pasi që nuk ka pasur përmirësime substanciale në vazhdimësi.

### Kostot për njësi<sup>2</sup>

#### Kostot për njësi të ujit të prodhuar

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është tregues po ashtu i rëndësishëm financiar në bazë të cilës kuptojmë shpenzimet për një m<sup>3</sup> të ujit të prodhuar.



**Fig. 13.** Kostoja për njësi e ujit të prodhuar gjatë 2020 në raport me vitin 2019

Kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në 2020 ka treguar një përmirësim të lehtë prej 4% krahasuar me vitin 2019, nga 0.05 euro/m<sup>3</sup> në 0.048 euro/m<sup>3</sup>.

Kostoja e prodhimit të ujit sillet nga 0.01 Euro/m<sup>3</sup> tek KRU “Hidrodrini” në 0.10 tek KRU “Hidroregjioni Jugor”.


Përmirësimi më i lartë i koston për njësi e ujit të prodhuar në raport e vitin e kaluar ishte tek KRU “Hidrodrini” me rreth 50% përmirësim (nga 0.02 Euro/m<sup>3</sup> sa ishte në 2019 në 0.01 Euro/m<sup>3</sup> për vitin 2020), rezultat i të cilës ishte zvogëlimi i ujit të prodhuar duke u pasuar pastaj edhe me zvogëlimin e shpenzimeve të ujit të prodhuar.

#### Kostoja totale për njësi e shërbimit të furnizimit me ujë,

<sup>2</sup>Kostot për njësi për vitin paraprak 2019 janë të rregulluara për normë të inflacionit 1.02



Paraqet shpenzimet totale, përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale të aktivitetit biznesor për furnizim me ujë, përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija, të gjitha në raport me volumin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.



**Fig. 14.** Kostoja për njësi e shërbimit të furnizimit me ujë, (€ për m<sup>3</sup> ujë të shitur)


Në vitin 2020 në nivel të sektorit, kostoja për njësi e shërbimit të furnizimit me ujë ka qenë 0.40 € për m<sup>3</sup> dhe nuk ka dallim nga ajo e vitit paraprak.

Siç vërehet edhe nga figura më lartë ekziston një amplitudë e gjerë sa i përket koston totale për njësi të shërbimit të furnizimit me ujë, që nga KRU “Hidrodrini” i cili ka nivel dukshëm më të ulët të koston së të gjitha kompanitë tjera të ujit më 0.23 €/m<sup>3</sup> deri tek ajo me e lartë për KRU “Prishtina” më 0.41 për m<sup>3</sup> të ujit të furnizuar, e cila ka mbet në nivel të njëjtë me vitin paraprak. Përmirësim të lartë të koston për njësi të shërbimit të furnizimit me ujë e shohim të KRU “Hidroregjioni Jugor” nga 0.47 €/m<sup>3</sup> sa ishte në vitin 2019 në 0.40 €/m<sup>3</sup> për vitin aktual, rezultati rrjedh nga zvogëlimi i shpenzimeve operative kryesisht për mirëmbajtjen kapitale dhe rritjes së shitjeve volumetrike të ujit të faturuar.

#### Kostoja totale për njësi e shërbimit të furnizimit me ujë e realizuar në raport me atë të planifikuar

Është një tregues financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor, dhe si i tillë ka ndikim në performancën e furnizimit me ujësjellës.

Ky tregues paraqet koston njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të realizuara (shpenzimet operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale zbritur për subvencionet e pranuar / shitjet volumetrike) në raport me koston e planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale/ shitjet volumetrike).



**Fig. 15.** Kostoja për njësi e shërbimit të furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi


Në nivel sektori përmbushja e objektivave të kostove për njësi e shërbimit të furnizimit me ujë në 2020 është në nivelin prej 95%, që do të thotë se ky realizim ka devijuar nga objektiva e planifikuar për 5%.

Përmbushja e kostove të planifikuara për njësi në shumicën e KRU-ve ishin nën nivelin prej 90%, megjithatë edhe kjo nuk tregon një performancë shumë të mirë, për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për ripërtëritjen infrastrukturore dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja e që këto kompani nuk kanë arritur ti realizojnë ato as 20% të tyre.

Performancë më e dobët është treguar nga KRU “Gjakova”, “Prishtina” dhe KRU “Bifurkacioni”. Arsyja e performancës së dobët qëndron në tejkalimin e shpenzimeve operative të planifikuara dhe në mos realizimin e shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale si dhe shitjeve të ujit të planifikuara gjatë procesit tarifar 2018-2020 (viti 2020).

### Shpenzimet kapitale për ujësjellës

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale aktuale në shërbimin e furnizimit me ujë të ndërmarra nga KRU, në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit për vitin 2020.



**Fig. 16.** Shpenzimet kapitale për shërbimin e furnizimit me ujë

Kompanitë për vitin 2020 sikurse edhe vitet e kaluara kanë planifikuar shpenzime për mirëmbajtje dhe rritje kapitale dhe atë rreth 31mil. Euro. Këto mjete janë paraparë të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet.

Shpenzimet aktuale në shumicën e KRU-ve, në përjashtim të KRU “Gjakova” dhe “Hidrodrini” ishin më të ulëta së niveli i pritur dhe atë duke filluar prej 1% të KRU “Mitrovica” e deri të KRU “Hidromorava” me 42%. Vihet re së shumica e investimeve të realizuara e të deklaruara nga kompanitë kanë vazhduar të jenë kryesisht nga Grantet, (donacionet zhvillimore), përjashtuar KRU “Hidrodrini” e cila në vitin 2020 nuk ka pranuar asnjë donacion.

Vlera e investimeve nga të hyrat vetanake për vitin 2020 ka qenë rreth 2,4 mil.Euro, ndërsa nga Grantet prej 4.1 mil. Euro. Në nivel të sektorit për vitin 2020 kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzojnë rreth 3 mil. Euro të cilat edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, cak ky i cili është realizuar në nivelin prej 81%.

**Tab 2. Vlera e investimeve në shërbimin e ujit**

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujit nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2020				
Kompania	Inv. në prodhim	Inv.në distribuim	Inv.në aktivitete biznesore	Totali
Prishtina	81,783	82,700	17,944	<b>182,427</b>
Hidroregjioni Jugor	24,333	2,489,975	62,960	<b>2,577,268</b>
Hidrodrini	143,532	203,474	19,998	<b>367,004</b>
Mitrovica	-	242,212	-	<b>242,212</b>
Gjakova	27,399	2,510,014	258,040	<b>2,795,453</b>
Bifurkacioni	3,098	693	10,567	<b>14,358</b>
Hidromorava	252,973	-	2,058	<b>255,031</b>
<b>Totali</b>	<b>533,118</b>	<b>5,529,068</b>	<b>371,567</b>	<b>6,433,753</b>

Këtë vit, prinë KRU “Gjakova”, me realizimin e shpenzimeve kapitale prej 2.8 mil.euro prej të cilave pjesa me e madhe e këtyre investimeve janë realizuar në distribuim dhe atë në rritje të infrastrukturës e kryesisht në zgjerim të rrjetit në 30 vendbanime të Gjakovës. Me këto shpenzime, është synuar të rritet edhe mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit e cila vërehet edhe nga fig,16.

KRU “Hidroregjioni Jugor” në raport me kompanitë mbetet në rendin e dytë për realizim të investimeve në nivelin prej 2.6 mil euro ku pjesën me të madhe të tyre i ka realizuar rritje të infrastrukturës në distribuim dhe atë kryesisht zgjerim të rrjetit në 11 vendbanime. Nga kjo kompani janë pritur të bëhen investime të konsiderueshme në projektet e ndërtimit dhe rehabilitimit të rrjetit të ujësjellësit edhe në disa lagje dhe fshatra të tjera të Prizrenit, por që këto mos realizime mund ti atribuohen mos realizimit të objektivave të faturimit dhe të arkëtimit njëkohësisht edhe mos pranimit të donacioneve të planifikuara në Biznes Planet e tyre për vitin 2020.

Kompania e cila ka realizuar me se paku investime është KRU “Bifurkacioni” dhe në raport me ato qe ka planifikuar vetëm 1% të tyre ka realizuar.

## 2.2 SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

### 2.2.1 Performanca jo-finaciare (teknike)

#### Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara


Aktualisht shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura në vend është shumë i ulët. Është vetëm një impiant i trajtimit të ujërave të ndotura në Skenderaj i menaxhuar nga KRU “Mitrovica” dhe disa impiante të vogla në nivel të fshatrave të menaxhuara nga KRU “Prishtina”, nga të cilat kemi mundur të sigurojmë të dhëna adekuate. Pjesa tjetër e ujërave të ndotura të shkarkuara nga KRU-të nuk arrijnë t’i përmbushin standardet mjedisore.

Ne po shpresojmë që në vitet e ardhshme ky shërbim do të jetë funksional, meqenëse kemi hyrë në një fazë të: planifikimeve, investimeve dhe ndërtimeve intensive të impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura. Impiante të tilla me kapacitete të konsiderueshme janë në fazën e ndërtimit dhe funksionalizimit në regjionin e Prizrenit, Pejës dhe Gjakovës.

#### Frekuenca e bllokimit të kanalizimit

Ky tregues paraqet numrin e rasteve të raportuara në lidhje me bllokimet e kanalizimeve të raportuara në periudhën raportuese për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit të menaxhuar nga KRU-të.

Pra, rezultati pasqyronë si gjendjen e rrjetit ashtu edhe nivelin e shërbimit ndaj konsumatorëve.



**Fig.17.** Numri i bllokimeve për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit


Në përjashtim të KRU “Gjakovës” tek të gjashtë KRU-të e tjera gjatë vitit 2020 është raportuar rritje e nivelit të bllokimeve të sistemit të kanalizimeve për 100 kilometra. Ato në nivel mesatar u rritën nga 441 raste sa ishin në vitin 2019 në 617 raste gjatë vitit 2020. Kompania e cila ka raportuar më së shumti raste sa i përket bllokimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë vitit 2020 është KRU “Hidrodrini” me 2,591 raste për 100 km gjatësi të rrjetit të kanalizimit e cila nëse krahasohet me vitin paraprak 2019 nuk ka pas as edhe një rast të raportuar sa i përket këtij treguesi.

Performanca e një sistemi kanalizimi është ndikuar nga sistemi i vjetër i rrjetit të kanalizimit, mbingarkesa nga rritja e madhe e popullatës sidomos në vendet urbane. Faktorë tjetër ndikues është së një pjesë e sistemit të kanalizimit është i përbashkët me sistemin e kanalizimit atmosferik dhe ndonjë herë mbetet pa përkujdesjen e duhur nga organet përgjegjëse. Pastrimi i rregullt i sistemit të kanalizimit është përgjegjësi ligjore e kompanive, ato nuk kanë prezantuar një plan vjetor të mirëmbajtjes (pastrimit) të rregullt preventiv për të dy rrjetet. Dhe kjo me siguri ka ndikuar në performancën e dobët të sistemit të kanalizimit.

## 2.2.2 Performanca jo-financiare (komerciale)

### Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizimi)

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të ujërave të ndotura (kanalizim).



**Fig.18.** Mbulueshmëria e popullatës me shërbime të ujërave të ndotura (%)

Përveç shërbimit të furnizimit me ujë, KRU-të sigurojnë edhe shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura. Në vitin 2020, ky shërbim është siguruar për rreth 65% të popullatës<sup>3</sup> dhe nëse krahasohet me vitin paraprak 2019, ka mbetur në pozitën e njëjtë.

Sa i përket mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura në pozitën më të mirë qëndron KRU "Prishtina" edhe pse nëse krahasohet me vitin paraprak 2019 ka mbetur në pozitën e njëjtë 78%.


Në pozitën e fundit është ranguar KRU "Hidrodrini" me 45% mbulueshmëri me shërbime të ujërave të ndotura e cila nëse krahasohet me vitin paraprak 2019 po ashtu ka mbetur në pozitën e njëjtë.

Gjatë vitit 2020, pothuajse të gjitha KRU-të kanë mbetur në pozitën e njëjtë me vitin paraprak në përjashtim të KRU "Hidromoravës" e cila ka shënuar progres simbolik për 1%.

### Ankesat

Numri i ankesave është një tregues i rëndësishëm për vlerësimin se sa janë të kënaqur konsumatorët në lidhje me shërbimin e marrë nga ofruesi i tyre i shërbimeve.

<sup>3</sup>Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës që furnizohen nga sistemet e menaxhuara nga KRU në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së licencuar të shërbimit.



**Fig.19.** Numri i ankesave për shërbimin e ujërave të ndotura

Në total gjatë vitit 2020, numri i ankesave për shërbimet e ujërave të ndotura arrin në 6,271, prej të cilave të gjitha ankesat janë të natyrës teknike.

Gjatë vitit 2020 numri i ankesave për shërbimet e ujërave të ndotura ka shënuar rritje për 3,383 ankesa me shumë krahasuar me vitin paraprak 2019 apo shprehur në përqindje për 117%.


Numri më i madh i ankesave gjatë vitit 2020 për shërbimin e ujërave të ndotura është paraqitur nga KRU “Prishtina” me gjithsej 2,670 ankesa, ndërsa kompania e cila ka prezantuar me se paku ankesa në shërbimin e ujërave të ndotura është KRU “Bifurkacioni” me vetëm 3 raste.

Ankesat në këtë shërbim kryesisht kanë qenë në lidhje me bllokimet e kanalizimeve, rastet e përmbytjeve dhe kërkesave për pastrim të kanalizimit.

### 2.2.3 Performanca financiare

#### Vlera e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura (EUR)

Fig. 20, si me poshtë paraqet performancën e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU-ve për procesin e rishikimit tarifor 2018-2020 (viti 2020).



**Fig. 20.** Shitjet e ujërave të ndotura në raport me planifikimet


Performanca jo e mirë e shitjeve aktuale të ujit krahasuar me shitjet e planifikuara, ka ndikuar që edhe shitjet aktuale në shërbimet e ujërave të ndotura në nivel të sektorit të jenë nën nivelin e vlerës së planifikuar pasi që kjo e dhënë është drejtpërdrejtë e lidhur me volumin e shitjeve të ujit.

Shumica e KRU-ve nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të ndotura gjatë vitit 2020 në përjashtim të KRU “Hidromroava”, “Hidrodrini” dhe KRU “Mitrovica” të cilat madje i kanë tejkaluar objektivat e planifikuara për 18% (Hidromroava), 8% (Hidrodrini), dhe 1% (Mitrovica).

Kompania e cila ka arritur ta këtë performancën me të dobët në realizimin e shitjeve të ujërave të ndotura është KRU “Bifurkacioni” me 81%, njëkohësisht me një rënie prej 1% krahasuar me vitin paraprak 2019.

Në nivel të sektorit në vitin 2020 vlera e shitjeve të realizuara për shërbimet e ujërave të ndotura ishte rreth 4.1 mil€ ndërsa ajo e planifikuar 4.4 mil€, kjo do të thotë së 92% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar dhe është me e lartë për 2% krahasuar me vitin 2019.

### Vlera relative e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura



**Fig. 21.** Vlera e shitjeve të shërbimit me ujëra të ndotura gjatë vitit 2020 në raport me 2019


Figura më lart tregon trendët e vlerës së shitjeve të realizuara për shërbimet e ujërave të ndotura gjatë periudhës raportuese 2020 në raport me vitin 2019, dhe në nivel sektori shihet që trendi ka qenë negativ me rënie prej 11% në raport me vitin e kaluar.

Sikurse të shërbimet e ujësjellësit ashtu edhe tek shërbimet e ujërave të ndotura KRU “Mitrovica” prinë me realizimin e shitjeve më të larta në raport me vitin paraprak, rezultat i cili i atribuohet rritjes së bazës së konsumatoreve pastaj edhe rritjes së shitjeve volumetrike për shërbimet e ujësjellësit.

KRU “Hidroregjioni Jugor” këtë vit mbetet kompania me realizimin me të ulët të shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura në raport me vitin e kaluar dhe atë me 34% rënie, për dallim nga viti i kaluar ku printe me realizimin e shitjeve me të larta. Rezultat i kësaj rënie, përkundër rritjes së shitjeve volumetrike për ujësjellës, ka qenë kryesisht zvogëlimi rreth 40% i tarifës së ujërave të ndotura. Zvogëlimi i tarifës ka ndodhur për arsye se ITUN në KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ ishte planifikuar të hyj në operim në vitin 2019, por për shkaqe të caktuara ky ITUN u fut në operim në Janar të vitit 2021.

### Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura<sup>4</sup>

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura janë të definuara si kosto vjetore duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale për konsumatorët shtëpiak të shërbyer<sup>5</sup>.



**Fig. 22.** Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura

Kostoja mesatare për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura në 2020 ka treguar një përmirësim të lehtë prej 4% krahasuar me vitin 2019, nga 6.55 euro/kons. në 6.31 euro/kons. Trendi pozitiv i atribuohet ngritjes së numrit të konsumatorëve shtëpiak të shërbyer, përkundër rritjeve të shpenzimeve totale për ujëra të ndotura.

Në vitin 2020 gati të gjitha kompanitë kanë pas rënie të koston për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura, në përjashtim të KRU “Hidrodrini”, e cila ka shënuar rritje të koston për njësi për 46% me të lartë se sa në vitin paraprak, si rezultat kryesisht i rritjeve të shpenzimeve në këtë shërbim.

Më koston më të ulët në këtë tregues, edhe këtë vit prinë KRU “Prishtina”, me 1.83 EUR/kons. me një trend pozitiv krahasuar me vitin paraprak, përderisa përmirësimin më të lartë për vitin 2020 në raport me vitin 2019 ka KRU “Gjakova”, me një rënie prej 17%, rezultat i të cilës kanë qenë shpenzimet e ulëta operative dhe rritjes së rritjes së numrit të konsumatorëve të shërbyer.

### Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura e realizuar në raport me atë të planifikuar


Është tregues tjetër financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor, dhe si i tillë ka ndikim në performancën e shërbimeve të ujërave të ndotura.

Ky tregues paraqet raportin në mes koston për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të realizuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/me ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak) dhe koston për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak).

<sup>4</sup> Kostoja për njësi e vitit 2019 është e rregulluar për normën të inflacionit 1.002 dhe ndryshon nga kostoja e paraqitur ne Raportin paraprak

<sup>5</sup> Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definoen si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatoreve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.






**Fig. 23.** Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me kostot e planifikuara për njësi(%)

Përmbushja e kostove të planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifor (2018-2020) konkretisht për vitin 2020 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2017), në të gjitha KRU ishin më të ulëta se sa ato të planifikuara.

Edhe pse kompanitë kanë arritur pothuajse nivelin e dëshiruar me të ulët se 90%, prapë këto kompani nuk kanë treguar performancë të mirë, për arsye së shumica prej tyre kanë tejkaluar shpenzimet operative, përderisa shpenzimet për mirëmbajtje kapitale nuk ka arritur as 9% të tyre ti realizojnë.

#### Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujërave të ndotura në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit për vitin 2020.



**Fig. 24.** Shpenzimet kapitale në shërbimin e ujërave të zeza në raport me planifikimet

Kompanitë për vitin 2020 sikurse edhe të shërbimet e ujësjellësit kanë paraparë shpenzime për mirëmbajtje dhe rritje kapitale dhe atë rreth 9mil. Euro. Këto mjete janë paraparë të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet.

Shpenzimet aktuale në të gjitha kompanitë pa përjashtim ishin më të ulëta se niveli i pritur, dhe atë prej 7% nga ajo që ishte planifikuar.

Investimet e realizuara e të deklaruar nga kompanitë kanë vazhduar të jenë kryesisht nga Grantet, (donacionet zhvillimore) dhe atë ne nivelin prej 95%.

Në nivel të sektorit për vitin 2020 kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzojnë rreth 1.1 mil. Euro të cilat edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, cak ky i cili është realizuar në nivelin prej 3%. Sa i përket investimeve të realizuara në shërbimet e ujërave të ndotura ne raport me planifikimet prinë KRU “Hidrodrini” me 74%, të cilat kryesisht kanë qenë të orientuara në mirëmbajtje të aseteve jo infrastrukturore (grumbullimi i ujërave të ndotura).

**Tab. 3. Vlera e investimeve në shërbimin e ujërave të ndotura**

Realizimi i investimeve në shërbimet e ujërave të ndotura nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2020					
KRU	në grumbullim	në trajtim	në shkarkim	akt. biznesore	Totali
Prishtina		0	0	0	555
Hidroregjioni Jugor	118,045	143,500	0	9,242	270,787
Hidrodrini	403,052	0	0	2,402	405,454
Mitrovica	0	0	0	0	0
Gjakova	140	0	0	13,779	13,919
Bifurkacioni	0	0	0	3,332	3,332
Hidromorava	0	0	0	108	108
<b>Totali</b>	<b>534,774</b>	<b>143,500</b>	<b>0</b>	<b>29,418</b>	<b>707,692</b>


Për dallim nga shërbimet e ujës-jellësit ku printe KRU “Gjakova”, në shërbimin e ujërave të ndotura prinë KRU “Hidrodrini” me realizimin e investimeve prej 58%, të shumës totale të investimeve dhe e cila përqindje është realizuar kryesisht në mirëmbajtje të jo-infrastrukturës për grumbullimin e ujërave të ndotura.

KRU “Gjakova”, është një ndër kompanitë që ka planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura: rehabilitim të rrjetit, në ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura, montimi dhe sigurimi i kapakëve për puseta të kanalizimit fekal, etj, e që realisht kjo kompani nuk ka arritur as 1% të tyre të realizojë.

## 2.3 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME FINANCIARE E KRU-ve

### 2.3.1 Arkëtimi i të ardhurave

Në vijim është paraqitur performanca e kompanive në treguesin shkalla e arkëtimit për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, i paraqitur si raport në mes të arkëtimit të keshit ndaj faturimit të rregullt për shërbimet e ofruara të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, duke përjashtuar taksat e kyçjes dhe të ardhurat tjera operative. Ky është njëri prej treguesve me domethënës i cili krahas efijencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka impakte të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë financiare të kompanive.




**Fig. 25.** Efijenca në arkëtimin e të ardhurave/ faturimin (përjashtuar të ardhurat e tjera operative)

Shkalla e arkëtimit për faturat e shërbimit të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura si mesatare e sektorit për vitin 2020 ishte 84% dhe është për 9% më e ulët se sa në vitin 2019. Kjo rënie e lartë në nivel të sektorit ka arritur të jetë si pasojë e gjendjes pandemike me COVID-19 dhe pastaj duke ndikuar në mos inkasimin e hyrave për shërbimet e ofruara ndaj konsumatorëve, përkundër rënies së të ardhurave të faturuara.

KRU “Gjakova”, edhe pse ka treguar trend negativ prapë mbetet përformuesi më i mirë në 2020, pasi arriti një efijencë të lartë në shkallën e arkëtimit prej 95%. KRU “Mitrovica”, mbetet me % e realizimit më të ulët të inkasimit në raport me kompanitë e tjera, përderisa kompania e cila ka arritur që ta ketë regresin më të lartë në vitin 2020 në raport me kompanitë tjera është KRU “Bifurkacioni”, me rënie prej 14% krahasuar me vitin paraprak.

Përkeqësimi i normës së arkëtimit ka ndodhur në të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Përderisa përkeqësimi me i dukshëm vërehet tek konsumatorët shtëpiak dhe mbetet ende sfidë për tu përmirësuar.

Objektiva e planifikuar me procesin tarifor për vitin 2020, në nivel të sektorit ka qenë 92%, përderisa ky cak aktualisht në nivel të sektorit ka devijuar për 8%. Objektivat e aprovuara nga autoriteti edhe në nivel individual nuk janë arritur, në përjashtim të KRU “Gjakova”, e cila ka kaluar për 2% cakun e planifikuar.




**Fig. 26.** Inkasimi i realizuar/inkasimi i panifikuar per vitin 2020 në nivel të kompanive

Efiçenca e lartë e arkëtimit të realizuar në raport me planifikimet në KRU “Gjakova” i përket në përgjithësi pagesave të faturave nga konsumatorët të institucioneve në nivelin prej 114%, por edhe një pjesë e konsumatorëve shtëpiak nga të cilat shumica e kompanive nuk mund të mbledhin keshin e faturuar.

### 2.3.2 Kthimi në kapital

Kthimi në kapital është komponent e ngarkesës tarifore që nga procesi tarifor 2009-2011 i garantuar edhe me Ligji nr. 05/1 -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Pra një normë reale të kthimit në kapital e cila është e bazuar në praktikat e mira të vendeve të Evropës Perëndimore. Për rishikimin tarifor 2018-2020, ARRU ka aprovuar një normë të vërtet të kthimit (pas inflacionit) prej 4% në bazën rregullatore të aseteve (BRRRA)<sup>6</sup>.



**Fig. 27.** Kthimi në bazën rregullatore të aseteve (BRRRA)

Kthimi në kapital në nivel të sektorit ka treguar trend negativ krahasuar me vitin paraprak dhe atë për 19% nga 4.82% sa ishte në vitin 2019 në 4.64% për vitin 2020.

Këtë vit në raport me vitin paraprak 4 nga 7 kompanitë kanë arritur të kenë trende pozitive, madje shumica prej tyre kanë tejkaluar nivelin e planifikuar prej 4%, që do të thotë se kanë arritur ti mbajnë shpenzimet e tyre,

<sup>6</sup> Për detaje të mëtejshme mbi bazën rregullatore të aseteve (se si është definuar dhe e përcaktuar) referojuni Udhëzimeve Rregullatore të Kontabilitetit të ARRU.


përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukurore në BRRA, brenda kufijve të të ardhurave të tyre.

Performanca me e mirë tek norma e kthimit në raport me kompanitë është treguar nga KRU "Hidrodrini" me 9.03%, përderisa përmirësimin më të lartë në vitin 2020 në raport me vitin paraprak ka arritur ta ketë KRU "Bifurkacioni" prej 7%. Kjo performancë e mirë dhe ndryshim kaq i lartë të këto dy kompani i dedikohet rritjes së të hyrave të faturuara dhe zvogëlimit të shpenzimeve operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale.

Performancë e dobët në raport me kompanitë e tjera duke mos arritur as kthimin e planifikuar vërehet të KRU "Gjakova" me 2.5%, dhe kjo si rezultat kryesisht i rritjes së shpenzimeve operative duke përfshirë edhe mirëmbajtjen kapitale dhe mbajtjes në nivel të njëjtë të të hyrave të faturuara.

### 2.3.3 Struktura e shpenzimeve operative

Kontrollimi i kostove operative është shumë kritike në ofrimin e shërbimeve. Shpenzimet e mëdha për personelin dhe energji të cilat në vitin 2019 për KRU ishin 78%, (nga totali i shpenzimeve) dhe tani 79% në vitin 2020 janë shpenzime që kanë ndikuar esencialisht në efikasitetin e KRU.



**Fig. 28.** Proporcioni i kategorive të shpenzimeve operative për sektorin 2019 dhe 2020

ARRU, parimisht nuk i ka sfiduar kostot e caktuara tek disa kategori, të tilla si kemikalet, meqenëse ka konsideruar se një reduktim i mundshëm i tyre mund të mos jetë domosdoshmërisht i dëshirueshëm, pasi kjo mund të ndikoj në cilësinë e ujit. Shpenzimet për këtë kategori janë të ulëta dhe atë 3%.

Normën më të lartë në strukturën e shpenzimeve operative tek kompanitë e ujit e përbëjnë shpenzimet për personelin dhe atë për 61% në vitin 2020, me një ngritje akoma prej 1% krahasuar me vitin paraprak, duke i tejkaluar njëkohësisht edhe shpenzimet e planifikuara për 5%.

KRU “Bifurkacioni” dhe “Hidromorava”, në raport me kompanitë e tjera kanë shpenzimet më të larta për personelin të cilat për vitin 2020, janë 76% (Bifurkacioni) dhe 70% (Hidromorava), përderisa përqindjen me të ulët në këtë kategori e ka KRU “Mitrovica” me 55% me një rritje prej 2% krahasuar me vitin 2019.

Kategorinë e dytë më të lartë të shpenzimeve e përbëjnë energjia, në mesataren e sektorit për vitin 2020, ato ishin 18% dhe kanë mbet në nivel të njëjtë me vitin 2019. Të shpenzimet e energjisë, KRU “Hidroregjioni Jugor”, tash e sa vite prinë me përqindjen më të lartë prej 22% nga totali i shpenzimeve operative si pasojë e funksionimit të pompave, meqë mënyra e kaptimit në përgjithësi është burimet nëntokësore. KRU “Gjakova” shpenzimet e energjisë i ka vetëm 8% nga pjesëmarrja në totalin e shpenzimeve operative.

## 2.4 PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E KRU-ve

Kjo pjesë ofron një përmbledhje të performancës së ofruesve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe trajtim të ujërave të ndotura. Si dhe jep renditjen e KRU-ve duke përdorur pesëmbëdhjetë tregues kyç të performancës për të dy sektorët (shërbimi i furnizimit me ujë dhe ujëra të ndotura) mbi bazën e cilësisë, niveleve të shërbimit, mbulueshmërisë dhe efikasitetit operative dhe kostos. Këto pastaj janë kombinuar dhe i është shtuar efikasiteti komerciale dhe financiare (ankesat, besueshmëria e të dhënave, arkëtimi i të ardhurave dhe kthimi në BRR) për të arritur në një matje të përgjithshme të performancës së KRU-ve.

Kriteret e matjes së performancës së shërbimit të furnizimit me ujë dhe shërbimit të ujërave të ndotura janë të tilla që një rezultat prej 100% pasqyron sigurimin e nivelit të shërbimit e krahasuar me një performancë moderne të shërbimeve efikase dhe funksionale të shërbimit të furnizimit me ujë.

Pesha e treguesve kryesorë të performancës është përcaktuar në varësi të rëndësisë relative të tyre në promovimin ose cilësinë e shërbimit, efikasitetit operativ dhe financiar në kuadër të grupimeve dhe strukturës së përgjithshme të performancës.

**Tab. 4.** Struktura e matjes së performancës (TKP dhe pesha e tyre)


Grupi	Njësia matëse e performancës	Koeficienti i nën-grupit		Koeficienti i Grupit	
<b>Ujësjiellës</b>	Cilësia e ujit të pijshëm	20%	100%	45%	100%
	Presioni	5%			
	Disponueshmëria	20%			
	Mbulueshmëria me shërbime të ujësjiellësit	20%			
	Efiçenca e kostos	10%			
	Uji i pa-faturuar	25%			
<b>Ujëra të ndotura</b>	Cilësia e shkarkimeve	10%	100%	30%	100%
	Besueshmëria	30%			
	Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura-kanalizimit	30%			
	Mbulueshmëria me shërbime të trajtimit të ujërave të ndotura	20%			
	Efiçenca e kostos	10%			

<b>Të përgjithshme - financiar dhe jo-financiar</b>	Ankesat e trajtuara me kohë	5%			
	Pikët (besueshmëria) e përcaktuara prej Auditimit	5%			
	Profitabiliteti	5%			
	Efiçenca komerciale	10%			

### 2.4.1 Performanca e përgjithshme - shërbimi i furnizimit me ujë

Një analizë gjithë përfshirëse e performancës së KRU, në lidhje me gjashtë tregues, domethënës operativ, financiar dhe niveli të shërbimit për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm është dhënë në vijim:

Performanca e përgjithshme e shërbimit të furnizimit me ujë, analizon dhe vlerëson, performancën e përgjithshme të KRU-ve duke marrë në konsideratë përpjekjet individuale të tyre në përmirësimin e TKP si: mbulueshmëria me shërbime të ujës-jellësit, cilësia e ujit të furnizuar, presioni i ujit, vazhdimësia e furnizimit, uji i pa-faturuar si dhe efijenca e kostos.



**Fig. 29.** Rezultatet e vlerësimit të performancës së shërbimit të furnizimit me ujë si dhe rangimi i KRU (2020)

Rezultati i performancës së shërbimit të furnizimit me ujë përbën 45% të vlerës së përgjithshme të performancës. Nga kombinimi i rezultateve në gjashtë treguesit kyç të performancës janë ranguar KRU, sipas performancës më të mirë për këtë shërbim.

Norma e përgjithshme e shërbimit të furnizimit me ujë në vitin 2020 është për 0,1% me e ulët (përkeqësuar) se në vitin 2019.

Vetëm KRU (Mitrovica, Hidroregjioni Jugor, Bifurkacioni dhe Gjakova), kanë shënuar përmirësim në shërbimin e furnizimit me ujë. Përderisa performancë më të dobët kanë treguar KRU (Hidromorava, Prishtina dhe Hidrodrini).

Përformanca e përgjithshme e KRU në nivel sektori në shërbimin e furnizimit me ujë në asnjë prej treguesve nuk ka arritur në nivelin e objektivave të ideale, treguesi i UPF dhe efijenca e kostos, mbulueshmëria me shërbime të ujës-jellësit, dhe vazhdimësia me furnizim janë tregues të cilëve KRU-të duhet ti përkushtojnë vëmendje në mënyrë që të kenë përmirësim të mëtutjeshëm në shërbimin e furnizimit me ujë.



**Tab. 5.** Rezultatet për performancën e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me ujë në vitin 2019

KRU	Cilësia e Ujit	Presioni	V. Furnizimit	Mbulueshmëria	UPF	Efiç. E kostove	Totali
<b>Ideal</b>	<b>20.0%</b>	<b>5.0%</b>	<b>20.0%</b>	<b>20.0%</b>	<b>25.0%</b>	<b>10.0%</b>	<b>45%</b>
GJA	20.0%	5.0%	20.0%	18.0%	12.3%	6.1%	36.63%
PE	19.9%	5.0%	19.9%	16.6%	0.0%	10.0%	32.13%
PR	20.0%	5.0%	19.6%	16.2%	1.3%	9.3%	32.12%
MIT	19.8%	5.0%	20.0%	14.2%	3.2%	5.0%	30.27%
PZ	20.0%	5.0%	20.0%	12.6%	2.9%	5.6%	29.73%
FE	19.7%	5.0%	18.7%	15.0%	0.0%	6.7%	29.29%
GJI	19.1%	4.5%	10.5%	12.0%	7.5%	8.9%	28.12%
<b>Sektori</b>	<b>19.8%</b>	<b>4.9%</b>	<b>18.4%</b>	<b>14.9%</b>	<b>3.9%</b>	<b>7.4%</b>	<b>31.2%</b>

**Tab. 6.** Rezultatet për performancën e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me ujë në vitin 2020

KRU	Cilësia e Ujit	Presioni	V. Furnizimit	Mbulueshmëria	UPF	Efiç. e kostove	Totali	Ndryshimi 2020/2019
<b>Ideal</b>	<b>20.0%</b>	<b>5.0%</b>	<b>20.0%</b>	<b>20.0%</b>	<b>25.0%</b>	<b>10.0%</b>	<b>45%</b>	
GJA	20.0%	5.0%	20.0%	19.8%	13.0%	4.2%	36.9%	0.3%
PR	20.0%	5.0%	19.8%	16.6%	1.5%	7.5%	31.7%	-0.4%
MIT	19.9%	5.0%	20.0%	15.4%	5.0%	5.0%	31.6%	1.3%
PE	19.9%	5.0%	19.9%	17.0%	0.0%	8.0%	31.4%	-0.7%
PZ	19.8%	5.0%	20.0%	13.4%	3.4%	7.0%	30.8%	1.1%
FE	19.4%	5.0%	18.9%	16.2%	0.0%	7.8%	30.3%	1.0%
GJI	19.9%	4.0%	3.0%	12.2%	9.2%	7.0%	24.9%	-3.3%
<b>Sektori</b>	<b>19.8%</b>	<b>4.9%</b>	<b>17.4%</b>	<b>15.8%</b>	<b>4.6%</b>	<b>6.6%</b>	<b>31.1%</b>	
<b>Ndryshimi 2020/2019</b>	<b>0.1%</b>	<b>-0.1%</b>	<b>-1.0%</b>	<b>0.9%</b>	<b>0.7%</b>	<b>-0.7%</b>	<b>-0.1%</b>	

KRU "Gjakova", vazhdon të ketë performancën më të mirë, me gjithsejtë 36.9% pikë të grumbulluara edhe për vitin 2020. Megjithëse trendi ishte në përmirësim, progresi ishte i ulët (vetëm 0.3%). Treguesi "eficenca e kostove", ishte ulur nga 6.1% në 4.2% për vitin 2020, Përndryshe kjo kompani ka arritur performancën e plotë në: cilësinë e ujit, presioni në rrjetë, furnizimi i vazhdueshëm si dhe afërsisht mbulueshmëria me shërbime të ujës-jellësit.

KRU "Hidromorava", ka treguar performancën me të dobët nga të gjitha kompanitë si dhe në raport me performancën e vetë të treguar gjatë vitit 2019. Përkeqësimi i performancës është për -3.3%, kryesisht e ndikuar nga mungesa e furnizimit të rregullt dhe në efikasitetin e kostove. Tek treguesi i vazhdimësisë së furnizimit me ujë ka arritur vetëm 3%, të pikëve nga 20%, sa është mundësia e plotë për tu arritur.

KRU "Mitrovica", ka shënuar progres tek treguesi i furnizimit me ujë, përmirësimi është për 1.3%, në raport me performancën e saj të treguar në vitin 2019. Përformanca më e mirë gjatë vitit 2020 ka qenë në treguesit: cilësia e ujit, mbulueshmëria me shërbime si dhe zvogëlimi i UPF.


## 2.4.2 Performanca e përgjithshme –shërbimi me ujëra të ndotura

Performanca e përgjithshme e shërbimeve me ujëra të ndotura, merr në konsideratë analizën dhe vlerësimin e arritjeve në TKP në këtë shërbim si: mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura, mbulueshmëria me trajtim të ujërave të ndotura, cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara si dhe besueshmëria e rrjetit të kanalizimit.

Vlerësimi i performancës së përgjithshme për shërbimin e ujërave të ndotura edhe këtë vit është bërë në bazë vetëm për dy tregues (mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura dhe efiçencës së kostos). Në bazë të dakordimit pas konsultimeve me ofruesit e shërbimeve, ARRU ka marrë vendim që : treguesi e lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura, do të hyn në vlerësim në momentin kur të gjitha KRU, do të marrin në menaxhim ITUN në zonat e tyre respektive të shërbimit.

Në mënyrë të ngjashme, pasi që besueshmëria për të gjitha KRU (e matur mbi bazën e bllokimeve për 100 km gyp në vit) është më e lartë se maksimalja absolute prej 100 nga niveli ideal, asnjë nga KRU nuk kanë mundur të sigurojnë ndonjë pikë. Kjo d.m.th së në këtë tregues performanca e të gjitha kompanive është e dobët.

**Performanca e përgjithshme në shërbimin e ujërave të ndotura**



**Fig. 30. Performanca e përgjithshme në shërbimin e ujërave të ndotura (2020)**

Norma e përgjithshme në shërbimin e ujërave të ndotura si mesatare gjatë vitit 2020, është për 0,1% me e përmirësuar se në vitin 2019.

Performanca e përgjithshme, në raport me nivelin e përgjithshëm ideal të synuar prej 30%, ka arritur nivelin prej 7.2% ,kjo është shumë e ulët në krahasim me nivelin e synuar prej 30%, të ndarë për këtë shërbim nga performanca e përgjithshme.

**Tab. 7. Rezultatet për performancën e përgjithshme në shërbimin e ujërave të ndotura në vitin 2019**

KRU	Cilësia e shkarkimeve	Besueshmëria	Mbulueshmëria me Kanalizim	Mbulueshmëria ITUN	Efiç. e kostos	Totali
<b>Ideal</b>	<b>10%</b>	<b>30%</b>	<b>30%</b>	<b>20%</b>	<b>10%</b>	<b>30%</b>
FE	0.0%	0.0%	22.2%	0.0%	5.4%	8.3%
GJA	0.0%	0.0%	20.1%	0.0%	6.8%	8.1%
PR	0.0%	0.0%	23.4%	0.0%	2.8%	7.9%
PZ	0.0%	0.0%	18.6%	0.0%	3.0%	6.5%
GJI	0.0%	0.0%	14.7%	0.0%	6.7%	6.4%
PE	0.0%	0.0%	13.5%	0.0%	7.7%	6.4%
MIT	0.0%	0.0%	18.0%	0.0%	2.7%	6.2%
<b>Sektori</b>	<b>0.0%</b>	<b>0.0%</b>	<b>18.6%</b>	<b>0.0%</b>	<b>5.0%</b>	<b>7.1%</b>

**Tab. 8. Rezultatet për performancën e përgjithshme në shërbimin e ujërave të ndotura në vitin 2020**

KRU	Cilësia e shkarkimeve	Besueshmëria	Mbulueshmëria me Kanalizim	Mbulueshmëria ITUN	Efiç. e kostos	Totali	Ndryshimi 2020/2019
<b>Ideal</b>	<b>10%</b>	<b>30%</b>	<b>30%</b>	<b>20%</b>	<b>10%</b>	<b>30%</b>	
FE	0.0%	0.0%	22.2%	0.0%	7.3%	8.8%	<b>0.6%</b>
PR	0.0%	0.0%	23.5%	0.0%	4.9%	8.5%	<b>0.7%</b>
GJA	0.0%	0.0%	20.2%	0.0%	7.3%	8.3%	<b>0.2%</b>
GJI	0.0%	0.0%	15.0%	0.0%	9.1%	7.2%	<b>0.8%</b>
PZ	0.0%	0.0%	19.8%	0.0%	2.3%	6.6%	<b>0.1%</b>
MIT	0.0%	0.0%	17.9%	0.0%	2.3%	6.1%	<b>-0.1%</b>
PE	0.0%	0.0%	13.6%	0.0%	1.9%	4.7%	<b>-1.7%</b>
<b>Sektori</b>	0.0%	0.0%	18.9%	0.0%	5.0%	7.2%	
<b>Ndryshimi 2020/2019</b>		<b>0.0%</b>	<b>0.3%</b>		<b>0.00%</b>	<b>0.1%</b>	

Performancën më të mirë në shërbimin e ujërave të ndotura e ka realizuar KRU “Bifurkacioni”, me totalin e pikëve 8.8%, nga maksimalja prej 30%. Megjithëse trendi ishte në përmirësim, progresi ishte i ulët (vetëm 0.6%). Treguesi efiçenca e kostos të KRU “Bifurkacioni” ka shënuar progres nga 5.4% sa ishte gjatë vitit 2019 në 7.3% në vitin 2020. Po ashtu KRU “Prishtina”, “Gjakova”, “Hidromorava” dhe “Hidroregjioni Jugor” kanë shënuar përmirësim në performancën e treguesve të shërbimi i ujërave të ndotura.

KRU “Hidrodrini”, ka treguar performancën më të dobët në raport me të gjitha kompanitë si dhe në raport me performancën e vet të treguar gjatë vitit 2019. Përkeqësimi i performancës është për -1.7%, kryesisht e ndikuar nga efiçenca e kostove. Tek treguesi i mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim) ka arritur përmirësim të vogël për 0.1%. Totali i pikëve të mbledhura nga kjo kompani në shërbimin e ujërave të ndotura është vetëm 4.7% dhe është shumë më e ulët nga totali prej 30%, sa është mundësia e plotë për tu arritur.


Shërbimi i ujërave të ndotura në raport me shërbimin e furnizimit me ujësjellës është shumë dobët i zhvilluar dhe ka nevojë për investime të konsiderueshme në përmirësimin e mbulueshmërisë me shërbime dhe ndërtimin e objekteve për trajtim të ujërave të ndotura, pa të cilat do të ishte e pamundur për KRU-të që të arrijnë përmirësime të prekshme në ofrimin e këtyre shërbimeve.

### 2.4.3 Performanca e përgjithshme e KRU-ve

Në vazhdim është dhënë performanca e përgjithshme e KRU-ve për të dy shërbimet, atë të shërbimit të furnizimit me ujësjellës dhe shërbimeve të ujërave të ndotura, duke u kombinuar me performancën financiare (profitabilitetin dhe efijencën komerciale), ankesat si dhe raportimin rregullator.

Nga kombinimi i rezultateve nga gjashtë fushat e vlerësimit të përgjithshëm: shërbimi i furnizimit me ujë, shërbimi me ujëra të ndotura, efijencën komerciale, profitabilitetin, ankesat dhe raportimi rregullator, KRU-të janë ranguar, duke u nisur nga performanca më e mirë.

Performanca mesatare e sektorit në vitin 2020, është në nivelin prej 57.9 %, dhe është për -1.38% më e ulët se në vitin 2019. Nevojitet përmirësim i përgjithshëm edhe për 42.11%, për të arritur maksimalen prej 100% (performanca ideale).



**Fig. 31.** Performanca e përgjithshme e KRU-ve në 2020

Bazuar në procedurat e renditjes, KRU “Gjakova” doli si performuesi më i mirë për vitin 2020, në performancën e përgjithshme për sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe shërbimit të ujërave të ndotura kjo kompani arriti 67.1% ndonëse performanca e saj në raport me performancën e treguar në vitin 2019 është për -2.1% më e ulët. Nga ana tjetër, performanca më e dobët ishte në KRU “Mitrovica” duke arritur vetëm 51.9 % pikë e që interpretohet si performancë e pakënaqshme. Në vitin 2020 performanca e KRU “Mitrovica” u përmirësua për 1.3%. përmirësim i shënuar te shërbimi i furnizimit me ujë dhe treguesi i profitabilitetit.

KRU “Hidrodrini”, (-6%) dhe Hidromorava (-3.7), ka shënuar rënie me të madhe të performancës nga të gjitha kompanitë.

Performanca në KRU “Hidrodriini”, është përkeqësuar në shërbimin e furnizimit me ujë, ujëra të ndotura, raportimi rregullator e sidomos performancë e dobët është treguar në arkëtimin e keshit. Përderisa trende negative tek KRU “Hidromorava”, janë evidente të furnizimi me ujë të pijshëm (vazhdimësia e furnizimit) dhe arkëtimi i të hyrave.

**Tab. 9.** Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU-të në vitin 2019

KRU	Furnizim me ujësjellës	Ujëra të ndotura	Profitabiliteti	Arkëtimi	Ankesat	Raportimi rregullator	Totali i Pikëve
<b>Ideal</b>	<b>45.0%</b>	<b>30.0%</b>	<b>5.0%</b>	<b>10.0%</b>	<b>5.0%</b>	<b>5.0%</b>	100.0%
GJA	36.6%	8.1%	5.0%	9.6%	5.0%	4.9%	69.22%
PR	32.1%	7.9%	5.0%	8.7%	5.0%	4.9%	63.56%
PE	32.1%	6.4%	5.0%	8.6%	4.8%	4.3%	61.16%
PZ	29.7%	6.5%	4.9%	8.7%	5.0%	4.6%	59.41%
GJI	28.1%	6.4%	5.0%	7.8%	4.9%	4.9%	57.15%
FE	29.3%	8.3%	0.9%	6.9%	4.9%	3.5%	53.79%
MIT	30.3%	6.2%	0.3%	4.5%	5.0%	4.2%	50.57%
<b>Total</b>	<b>31.2%</b>	<b>7.1%</b>	<b>3.7%</b>	<b>7.8%</b>	<b>4.9%</b>	<b>4.5%</b>	<b>59.26%</b>

**Tab. 10.** Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU-ve në vitin 2020

KRU	Furnizim me ujësjellës	Ujëra të ndotura	Profitabiliteti	Arkëtimi	Ankesat	Raportimi rregullator	Total i Pikëve	Ndryshimi 2020/2019
<b>Ideal</b>	<b>45.0%</b>	<b>30.0%</b>	<b>5.0%</b>	<b>10.0%</b>	<b>5.0%</b>	<b>5.0%</b>	100.0%	
GJA	36.9%	8.3%	3.2%	8.8%	5.0%	4.9%	67.11%	-2.1%
PR	31.7%	8.5%	5.0%	5.8%	5.0%	4.8%	60.84%	-2.7%
PZ	30.8%	6.6%	5.0%	8.2%	5.0%	4.6%	60.21%	0.8%
FE	30.3%	8.8%	5.0%	3.3%	5.0%	4.1%	56.58%	2.8%
PE	31.4%	4.7%	5.0%	4.9%	5.0%	4.2%	55.16%	-6.0%
GJI	24.9%	7.2%	5.0%	6.4%	5.0%	4.9%	53.40%	-3.7%
MIT	31.6%	6.1%	3.3%	2.1%	5.0%	3.8%	51.91%	1.3%
<b>Total</b>	<b>31.08%</b>	7.17%	4.50%	5.65%	5.00%	4.49%	57.89%	
<b>Ndryshim 2020/2019</b>	<b>-0.1%</b>	0.1%	<b>0.8%</b>	<b>-2.2%</b>		0.01%	<b>-1.38%</b>	

Pa përjashtim, KRU-të janë duke operuar në nivel shumë më të ulët se çfarë do të konsiderohej një nivel ideal i shërbimit. Arsyet kryesore që ndikojnë në performancën e përgjithshme janë: në përgjithësi shërbimi i ujërave të ndotura dhe mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura, uji i pa faturuar tek shërbimi i furnizimit me ujë dhe efienca e kostove si dhe efienca komerciale-arkëtimi.

Ne poashtu jemi të bindur se për shumicën nga përmirësimet e nevojshme kërkohen nivele të konsiderueshme të investimeve. Megjithatë për të siguruar investime të tilla KRU-të duhet të demonstrojnë aftësitë e tyre për të maksimizuar efiençën në ato zona që ato janë nën kontroll të drejtpërdrejtë të tyre, në veçanti në efiençën e arkëtimin të të ardhurave dhe efiençën e kostove operative dhe zvogëlimin e UPF. ARRU do të angazhohet edhe me tej në sigurimin që tarifat e përcaktuara të jenë të mjaftueshme për të financuar planet e nevojshme të investimeve. Por kompanitë duhet të sigurojnë efiençë operative dhe financiare me synimin përfundimtarë që konsumatorët të marrin shërbime cilësore dhe të qëndrueshme.

### 3. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT MË SHUMICË

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE “Ibër Lepenci”, e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU “Mitrovica” dhe KRU “Prishtina”.

Në vazhdim, po i japim disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendët e zhvillimit të performancës në vitin 2020, në raport me vitin 2019.

**Tab. 11.** Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenci'

<b>Të dhënat statistikore për 2020 / 2019</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	48,917,200	51,200,467
Faturimi për ujin me shumicë (€)	1,210,418	1,293,828
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	1,232,953	1,255,533
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	1,359,052	1,492,622
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	69	81

Në vitin 2020 siç edhe vërehet nga tabela me lartë, shitjet e ujit në vlerë sasiore për KRU “Mitrovica” dhe KRU “Prishtina”, janë ngritur në nivelin prej 2.3 mil. m<sup>3</sup> ose 5% në raport me vitin 2019, duke reflektuar pastaj edhe në rritjen e shitjeve të ujit në vlerë monetare për 7%. Po ashtu, janë rritur edhe shpenzimet për furnizimin e ujit me shumicë në nivelin prej 10%, rritje e cila vërehet edhe nga rritja e numrit të punëtorëve nga 69 në 81. Në tabelën 13, është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE ‘Ibër Lepenci’ gjatë vitit 2020/2019.

**Tab. 12.** Treguesit e Performancës së NHE 'Ibër-Lepenci'

<b>Treguesi i performancës</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>
Shkalla e arkëtimit	102%	97%
Norma e punës	0.89	0.87
Norma e mbulimit të punës	0.91	0.84
Kostoja e operimit për njësi (€/m <sup>3</sup> )	0.03	0.03

Shkalla e arkëtimit në NHE ‘Ibër Lepenci’ është 97%, dhe devijimi i i arkëtimit të plotë prej 100% është rezultat i mospagesës së faturave nga ana e KRU “Mitrovica”.

Rritja e shpenzimeve prej 10%, përkundër rritjes së shitjeve të ujit, ka ndikuar që Norma e punës të jetë më e ulët krahasuar me vitin 2019. Norma e mbulimit të punës ka rënë për 7% në raport me vitin 2019 dhe mbetet ende nën nivelin e dëshiruar për të mbuluar shpenzimet e krijuara gjatë vitit 2020 për shërbimet e ofruara.

Shpenzimet operative për njësi në vitin 2020, kanë mbetur në nivelin e njëjtë me vitin 2019, rreth 0.03 €/m<sup>3</sup>. Edhe pse shpenzimet operative ishin me të larta këtë vit, nivelin e njëjtë të koston për njësi nga viti paraprak ka arritur ta ruaj rritja e shitjeve volumetrike të ujit të papërpunuar.

## 4. KUALITETI I TË DHËNAVE

Përgjegjësia për raportimin e të dhënave të kërkuara nga Rregullatori, qëndron tek kompanitë, përderisa ARRU është përgjegjës për vlerësimin e të dhënave të ofruara nga kompanitë në kontekst të saktësisë dhe besueshmërisë. Me qëllim që raporti vjetor i performancës për vitin 2020, të bazohet në informacione të besueshme, ARRU ka ndërmarrë aktivitetin e inspektimit të procedurave dhe praktikave të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave brenda kompanisë si dhe ka realizuar auditimin/verifikimin e të dhënave që i raportohen ARRU-së. Vlerësimi i besueshmërisë së të dhënave është bazuar në kriteret e dhëna në: “Udhëzuesin për avancimin e sistemit të monitorimit në ARRU dhe në KRU”. Të dhënat janë vlerësuar në kontekst të besueshmërisë së sistemit të mbajtjes së shënimeve, përditësimit të të dhënave, efikasitetit të përpunimit dhe gjenerimit të raporteve të kërkuara. Në aspektin e besueshmërisë dhe saktësisë, të dhënat janë vlerësuar në 3 kategori, të specifikuar me nota-norma korresponduese: (i) të besueshme - 100%, (ii) pjesërisht të besueshme - 50% si dhe (iii) jo të besueshme – 0%.

**Tab. 13.** Besueshmëria e të dhënave sipas KRU-ve për vitin 2020

KRU	Të dhënat jo financiare-ujësjellës	Të dhënat jo financiare-Ujëra të ndotura	Të dhënat financiare	Mesatarja e Përgjithshme e Ponderuar
Gjakova	97%	95%	99%	98%
Hidromorava	95%	97%	99%	98%
Prishtina	87%	89%	99%	97%
Hidroregjioni Jugor	92%	95%	91%	91%
Hidrodrini	82%	74%	85%	84%
Bifurkacioni	92%	95%	80%	83%
Mitrovica	59%	66%	81%	77%

Rezultatet e besueshmërisë së ulët të të dhënave, zakonisht tregojnë me shumë vlerësime, ndërsa rezultatet sa më të larta tregojnë: mirëmbajtje të shënimeve, matje të sakta dhe menaxhim të informacioneve me sisteme softuerike-automatike (telemetrisë) apo edhe formate të raporteve të sakta dhe të verifikueshme.

Shqetësimet e ARRU-së lidhen sidomos me disa të dhëna të rëndësishme të natyrës operative dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve, besueshmëria e këtyre të dhënave është e lidhur me: posedimin e ujëmatësve, sistemin e monitorimit telemetrik (SCADA), moduleve të qëndrueshme softverike për mirëmbajtjen e defekteve (CRM), sistemin informativ gjeografik (SIG) si dhe një proces të mirëfilltë për leximin, regjistrimin dhe raportimin e të dhënave.

Në përgjithësi besueshmëria e të dhënave në vitin 2020 në raport me vitin 2019 është përmirësuar tek KRU “Bifurkacioni”, “Hidrodrini” dhe “Mitrovica”.

Besueshmëria e të dhënave jo financiare në të dy shërbimet: ujësjellës dhe ujëra të ndotura, varësisht nga KRU-të, sillen me një gamë të gjerë dhe atë, nga me e ulëta në KRU “Mitrovica”, deri tek me e larta në KRU “Gjakova” dhe “Hidromorava”. Në mënyrë më specifike komentimi i besueshmërisë së të dhënave është si në vijim:

**Prodhimi i Ujit**, në KRU (Gjakova, Mitrovica dhe Hidromorava) është i besueshëm (100%), përderisa tek KRU (Prishtina, Hidroregjioni Jugor, Hidrodrini dhe Bifurkacioni), e dhëna e prodhimit të ujit është pjesërisht e besueshme, meqenëse këto kompani nuk kanë mbulueshmëri të plotë me ujëmatës apo edhe janë jo-funksional si rasti i KRU “Hidroregjionit Jugor”. Sistemi SCADA mungon plotësisht apo është funksional pjesërisht në disa ITU, të dhënat kryesisht mbahen në formate të raporteve apo edhe Excel tabela.

**Presioni i ujit**, në asnjë prej KRU-ve, nuk është i besueshëm, në rastin më të mirë e dhëna e presionit të ujit është pjesërisht e besueshme në KRU (Gjakova, Mitrovica, dhe Hidromorava). Në këto kompani presioni matët

në mënyrë telemetrike vetëm në kuadër të një numri të kufizuar të zonave DMA, apo edhe stacioneve të pompimeve.

**Vazhdimësia e furnizimit**, në kompanitë të cilat kanë reduktime, të dhënat janë pjesërisht të besueshme. Asnjëra prej KRU-ve nuk kanë sistem të monitorimit permanent (SCADA) në rrjetin shpërndarës. Disa nga KRU-të kanë deklaruar vazhdimësi të plotë të furnizimit si KRU ( Mitrovica, Gjakova si dhe Hidroregjioni Jugor), meqë kanë kapacitete të mjaftueshëm për furnizim të rregullt me ujë të pijshëm.

**Defektet në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit**, në shumicën e kompanive janë pjesërisht të besueshme. Shumica e KRU-ve, tani më kanë në përdorim module të avancuara për menaxhimin e informacioneve për mirëmbajtjen, (MMS/CRM), por ato nuk janë të përditësuara në tërësi si dhe nuk janë të integruara në tërësi zonën e shërbimit të kompanisë.

**Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit**, janë regjistruar në modulet e aplikacionit të SIG. Ky aplikacion siguron besueshmëri të lartë të informacioneve të lidhura me regjistrin e rrjetit dhe mirëmbajtjes së tij dhe janë funksionale në të gjitha KRU-të. Aplikacioni i SIG më i përditësuar me të dhëna është në KRU “Hidrodrini” dhe “Hidroregjioni Jugor” ndërsa në KRU “Bifurkacioni”, moduli i SIG është më pak i përditësuar e sidomos, sistemi i rrjetit të kanalizimit.

Të dhënat e shërbimeve ndaj konsumatorëve janë kryesisht me të besueshme se sa të dhënat operative. Të gjitha KRU-të kanë të instaluar aplikacione të avancuara për menaxhimin e të dhënave të relacionit me konsumatorë dhe ato janë të integruara në kuadër të programeve softverike. Për menaxhimin e të dhënave komerciale, disa shqetësime janë në kontekst të të dhënave vijuese:

Numrin e konsumatorëve dhe faturimin në vlerë sasiore në disa KRU (Mitrovica, Hidrodrini) janë pjesërisht të besueshme për shkakun se aplikacionet aktuale nuk kanë mundësi të ndarjes së të dhënave në kategorizimet e kërkuara për raportim.

**Ankesat e Konsumatorëve**, regjistrohen dhe menaxhohen përmes aplikacioneve softverike (CRM/CRS). Përditësimi më i mirë i këtyre moduleve është bërë nga KRU (Hidroregjioni Jugor, Gjakova, Hidromorava si dhe Bifurkacioni), të cilat edhe kanë prodhuar informacione të besueshme, përderisa KRU (Prishtina, Mitrovica dhe Hidrodrini), besueshmërinë në këtë kategori të të dhënave e kanë pjesërisht të besueshme, meqenëse nuk kanë bërë, ndarje të ankesave nga kërkesat apo edhe lajmërimet të cilat i bëjnë qytetarët.

**Të dhënat financiare**, në përgjithësi janë të besueshme, ato mbahen në aplikacione të avancuara të cilat mundësojnë gjenerim të të dhënave me saktësi dhe besueshmëri të madhe. Kryesisht janë në përdorim 5 lloje të aplikacioneve/programeve financiare nga KRU-të .

Përdorimi i programit ‘NAVISION’ nga KRU (Prishtina, Hidroregjioni Jugor dhe Bifurkacioni), si dhe RIKONT përkatësisht ASSECO të përdorura nga KRU “Hidrodrini” gjegjësisht nga KRU “Mitrovica”, mundësojnë përditësim dhe gjenerim të të dhënave totale në mënyrë të lehtë dhe të besueshme, përderisa vështirësitë paraqiten në përditësimin dhe raportimin e të dhënave të shpenzimeve dhe të dhënave tjera financiare sipas kosto qendrave dhe kategorizimeve të nevojshme, meqenëse kërkohet përpunimi i tyre shtesë në formate Excel, këto të dhëna janë vlerësuar-pjesërisht të besueshme.

Programi, ‘PRONET’ është në përdorim nga KRU “Gjakova”, dhe ALPHA BUSSNESS nga KRU “Hidromorava”, mundësojnë gjenerim të të dhënave financiare të besueshme, edhe sa i përket atyre të kategorizuara për shpenzimet operative, shitje etj.

Asnjëri nga këto programe nuk kanë mundësi të prodhojnë të dhëna mbi BARRA dhe zhvlerësimin e kostove aktuale, sipas kërkesave rregullatore, ato bëhen në formate Excel të proceduara nga ARRU.

ARRU sugjeron KRU-të të zhvillojnë edhe më tej teknologjinë e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave, sidomos duke i avancuar dhe instaluar: aplikacionet e të dhënave të relacionit me konsumatorë, GIS në rrjeta dhe mirëmbajtjen e tyre, SCADA sistemin në trajtim dhe shpërndarje të ujit.



## 5. KONKLUZIONE TË PËRGJITHSHME

Gjatë analizës së performancës së KRU-ve të paraqitura në këtë raport janë identifikuar një numër çështjesh në lidhje me eficienten dhe qëndrueshmërinë e shërbimit të ofruar prej tyre.

Si përfundim, në përgjithësi performanca e KRU-ve në vitin 2020 ka shënuar rënie në raport me vitin 2019. Përmirësime ka pasur në disa tregues, përderisa në disa të tjerë, kryesisht të lidhur me eficienten operative (vazhdimësinë e furnizimit me ujë) dhe financiare janë evidentuar ngecje:

### Arritjet:

- Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit është rritur në nivel sektori për 3%, të gjitha KRU-të kanë shënuar progres gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin paraprak 2019 edhe pse ende qëndrojnë larg nivelit ideal të mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit prej 100%, përjashtuar KRU “Gjakova”, ku në zonën e shërbimit të saj vetëm edhe 12 vendbanime nuk kanë qasje në shërbimin e furnizimit me ujë. Numri i konsumatorëve në shërbimin e furnizimit me ujë në vitin 2020 është 397,638 konsumatorë dhe në raport me vitin 2019 është rritur për 21,303 konsumatorë.
- Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizim), në vitin 2020, është siguruar për rreth 65% të popullatës dhe nëse krahasohet me vitin paraprak 2019, ka mbetur në pozitën e njëjtë. Krahas impiantit egzistues në Skënderaj dhe disa ITUN me kapacitete të vogëla, janë edhe tri ITUN, në fazën e ndërtimit dhe së shpejti do të hynë në funksion në tri qendra regjionale (Prizren, Pejë dhe Gjakovë) të cilat do të kenë impakt të rëndësishëm në përmirësimin e mjedisit.
- Cilësia e ujit, është e mirë, gjatë periudhës së vitit 2020 H1, ku janë testuar gjithsejtë 4,408 mostra prej të cilave 99.4%, janë në përputhje me vlerat parametrike të standardeve vendore. Të dhënat janë vetëm për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, aq sa na janë përcjellur nga IKSHPK. Të gjithë KRU-të, zbatojnë programet e monitorimit të cilësisë së ujit në përputhje me udhëzimet për monitorimin e cilësisë së ujit, tri prej tyre tashmë kanë laboratorët e akredituara (Prishtina, Gjakova dhe Prizreni).
- Norma e konsumatorëve të faturuar me ujëmatës është rritur, aktualisht kap vlerën prej 98%. Të gjitha KRU-të kanë shënuar performancë të mirë tek paisja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës gjatë vitit 2020 në raport me vitin paraprak 2019 dhe progresi është për 2%. KRU-të kanë raportuar mbi 21,772 ujëmatës të rinj të instaluar vetëm për kategorinë e amvisërisë në vitin 2020, KRU duhet të instalojnë edhe ujëmatësit e prodhimit të ujit në mënyrë që të përcaktojnë saktë sasinë e ujit të prodhuar.

### Sfidat:

Përkundër përmirësimeve të përmendura, raporti ka identifikuar fusha të cilat kanë nevojë për më shumë përmirësime kryesisht të lidhura me eficienten operative dhe financiare:

- Edhe gjatë vitit 2020, ka pas mungesë të të reshurave e që më së shumti ka pasur ndikim në regjionet e furnizimit nga KRU “Hidromorava”, “Bifurkacioni” dhe “Prishtina”. KRU “Hidromorava”, vetëm 6.4% të konsumatorëve të saj i ka furnizuar 24 orë me ujë të pijshëm.
- Presioni i ujit, duket që nuk është problem për tu siguruar por, shumica e KRU-ve, ende nuk kanë mundësi që të monitorojnë dhe sigurojnë informacione të besueshme për presionet në rrjetin e tyre të shërbimit. Ato nuk kanë sisteme të vendosura të manometrave dhe monitorimit on-line të rrjetit shpërndarës.
- UPF, është në trende graduale të zvogëlimit (përmirësimit), por është akoma e largët për të gjitha KRU arritja e një pikë referimi nën 25%. Presioni i institucioneve dhe publikut është në rritje për adresimin e UPF-mëqenëse kjo është duke shkaktuar mungesë të eficientës operative dhe financiare. Kompanitë duhet të arrijnë zvogëlim më të shpejtë i UPF-së, duke zbatuar strategjit dhe zhpenzimet investive të përfshijë në planet e tyre të biznesit.

- Asnjëra nga KRU-të nuk po i arrinë projeksionet për rritjen e faturimit të ujit, për vitin 2020 janë planifikuar të faturohen mbi 66 milion m<sup>3</sup> ujë nga të gjitha KRU, përderisa kanë arritur të realizojnë mbi 62 milion m<sup>3</sup>, kjo është vetëm 45% e ujit të prodhuar,
- Kostot e larta operative për ofrimin e shërbimeve që rrjedhin kryesisht nga rritja e shpenzimeve për personel dhe energji si dhe elementeve tjera operative.
- Arkëtimi jo i plotë i keshit, nga faturat e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe shërbimit të ujërave të ndotura, sidomos nga konsumatorët e amvisërisë.
- Sigurimi i besueshmërisë së të dhënave të raportuara në ARRU.

**Rekomandime për:**

- Ofruesit e shërbimeve, të vazhdojnë implementimin e strategjive individuale për zvogëlimin e ujit të pafaturuar.
- KRU “Hidromorava” dhe “Bifurkacioni”, të sigurojnë furnizim të qëndrueshëm, përmes investimeve në sisteme të ujësjellësit dhe burimeve ujore të garantojnë një furnizim të besueshëm dhe që u përshtaten kërkesave për ujë në të ardhmen nga këto dy kompani.
- KRU-të, të zhvillojnë më tej sistemin informativ për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, sidomos duke avancuar dhe instaluar: aplikacionin e të dhënave të relacionit me konsumatorë, GIS-in në rrjeta dhe mirëmbajtjen e tyre, SCADA sistemin në trajtim dhe shpërndarje të ujit, për të përmirësuar besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave sidomos të të dhënave operative dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve.
- KRU- të, ndërtojnë laboratorët dhe bëjnë akreditimin e tyre,
- KRU- të bëjnë integrimin e të gjitha skemave rurale të cilat janë jashtë sistemit të menaxhimit të tyre,
- Qeverinë -Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike dhe Bordeve të Drejtorëve të KRU-ve, për zbatimin e marrëveshjes–vendimit për performancën, bazuar në indikatorët e performancës dhe planeve të biznesit të aprovuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit.

## SHTOJCA 1: Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave (URRK)

**KRU Prishtina (Prishtinë)**

	2019	2020
Qarkullimi	14,673,192	13,932,702
Shpenzimet operative	10,232,526	10,099,459
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>4,440,666</b>	<b>3,833,243</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	722,777	634,113
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>3,717,889</b>	<b>3,199,130</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	415,548	748,452
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>3,302,341</b>	<b>2,450,678</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>3,302,341</b>	<b>2,450,678</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>3,302,341</b>	<b>2,450,678</b>

**KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)**

	2019	2020
Qarkullimi	4,823,060	4,898,130
Shpenzimet operative	3,978,733	3,886,757
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>844,327</b>	<b>1,011,373</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	225,169	74,548
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>619,158</b>	<b>936,825</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	189,876	241,933
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>429,282</b>	<b>694,892</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>429,282</b>	<b>694,892</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>429,282</b>	<b>694,892</b>

**KRU Hidrodrini (Pejë)**

	2019	2020
Qarkullimi	3,992,965	3,871,781
Shpenzimet operative	2,538,716	2,561,795
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>1,454,249</b>	<b>1,309,986</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	157,708	131,101
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>1,296,541</b>	<b>1,178,885</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	505,783	227,119
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>790,758</b>	<b>951,765</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>790,758</b>	<b>951,765</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>790,758</b>	<b>951,765</b>

**KRU Mitrovica (Mitrovicë)**

	2019	2020
Qarkullimi	4,418,591	4,466,254
Shpenzimet operative	3,430,928	3,535,423
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>987,663</b>	<b>930,831</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	20,942	21,183
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>966,721</b>	<b>909,648</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	949,794	729,599
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>16,927</b>	<b>180,049</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>16,927</b>	<b>180,049</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>16,927</b>	<b>180,049</b>

**KRU Gjakova (Gjakovë)**

	2019	2020
Qarkullimi	4,568,298	4,576,868
Shpenzimet operative	3,541,550	3,697,304
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>1,026,749</b>	<b>879,564</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	362,003	474,353
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>664,746</b>	<b>405,211</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	151,615	70,104
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>513,130</b>	<b>335,107</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>513,130</b>	<b>335,107</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>513,130</b>	<b>335,107</b>

**KRU Bifurkacioni (Ferizaj)**

	<b>2019</b>	<b>2020</b>
Qarkullimi	2,071,257	2,144,490
Shpenzimet operative	1,573,376	1,535,549
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>497,881</b>	<b>608,942</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	30,918	27,788
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>466,963</b>	<b>581,154</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	437,483	251,578
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>29,479</b>	<b>329,575</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>29,479</b>	<b>329,575</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>29,479</b>	<b>329,575</b>

**KRU Hidromorava (Gjilan)**

	<b>2019</b>	<b>2020</b>
Qarkullimi	2,467,273	2,316,101
Shpenzimet operative	1,806,015	1,848,835
<b>Të hyrat operative neto (pa përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>661,258</b>	<b>467,266</b>
Mirëmbajtja kapitale (përtëritja infrastrukurore + zhvlerësimi i kostos së tanishme)	42,845	42,127
<b>Të hyrat operative neto (përfshirë mirëmbajtjen kapitale)</b>	<b>618,413</b>	<b>425,139</b>
Provizionimi i borxheve të këqija	376,410	187,246
<b>Të hyrat operative neto (pas borxheve të këqija)</b>	<b>242,003</b>	<b>237,893</b>
Kamata në huatë afatgjata	0	0
<b>Profiti para tatimit</b>	<b>242,003</b>	<b>237,893</b>
Tatimi në profit	0	0
<b>Profiti neto pas tatimit</b>	<b>242,003</b>	<b>237,893</b>

## SHTOJCA 2: Detajet e kontaktit



### **Albana Abazi-Haliti**

Analiste e Performancës  
Teknike

**Tel (+383 38 249 165-lok  
137)**

[albana.abazi@arru-rks.org](mailto:albana.abazi@arru-rks.org)



### **Jasmina Bujupi**

Analiste e Performancës  
Financiare

**Tel (+383 38 249 165-lok  
117)**

[jasmina.bujupi@arru-rks.org](mailto:jasmina.bujupi@arru-rks.org)



### **Lule Aliu**

Zyrtare për Informim dhe  
Monitorim të Mediave  
(Asistente Ekzekutive)

**Tel (+383 38 249 165-lok 101)**

[lule.aliu@arru-rks.org](mailto:lule.aliu@arru-rks.org)



### **Mejreme Qerimi**

Analiste e shërbimeve me  
Konsumatorë

**Tel: (+383 38 149-165- lok:  
113)**

[mejreme.qerimi@arru-rks.org](mailto:mejreme.qerimi@arru-rks.org)

## Informacionet për ARRU

### Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit-ARRU

Zëvendës Drejtori	Xhelal Selmani	038/249 165/114	xhelal.selmani@arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licencim	Behxhet Bala	038/249 165/112	behxhet.bala@ arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Drejtor i Departamentit për Raportim të Performancës	Qamil Musa	038/249 165/121	qamil.musa@ arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Drejtor i Departamentit për Tarifa	Refik Rama	038/249 165/120	refik.ramaj@ arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Drejtor i Departamentit për Administratë dhe Financa	Ramiz Krasniqi	038/249 165/110	ramiz.krasniqi@ arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000
Udhëheqës i Njësisë për Inspektim	Zoge Spahiu	038/249 165/135	zoge.spahiu@arru-rks.org	Rr. Ali Pashë Tepelena, Prishtinë, 10000



*ARRU - Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit*  
*Rr.Ali pashë Tepelena, Nr.01*  
*Prishtinë, 10000, Kosovë*